




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 Qershor, 2008), dhe të Nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të Nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL), Nr 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, në Nenin 6 pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, nr 01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e -VII-, të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datë: **31.07.2019, (e Mërkurë)**, duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në **Bibloteekën** në Shtëpinë e Kulturës, "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti.

Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e Kuvendit Komunal të Vitisë.
2. Informatë për punën e kryetarit të komunës për periudhën janar-qershor 2019
3. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-qershor 2019
4. Informatë lidhur me Raportin e auditimit për Pasqyrat Financiare të Komunës së Vitisë për vitin përfundimtar me 31.12.2018.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimi për inicimin e themelimit të Teatrit të Qytetit
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik projekt planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2020.
7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik për propozim rregullore për Tatimit në prone për vitin 2020

Vërejtje: (Rendi i ditës për këtë seancë është bërë pa rekomandimet e KPF-së pasi që nuk ka pasur kuorum që të mbahet mbledhja e KPF-se)

Viti, më 24.07.2019

Kryesuesi i Kuvendit
Naim Pira






Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosova



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Vitina



INFORMATË PËR PUNËN E KRYETARIT TË KOMUNËS
(JANAR – QERSHOR 2019)

PËRMBAJTJE

Përmbajtje	2
Hyrje	3

KAPITULLI II

Raporti i Zyrave të Kryetarit	5
- Njësia e Auditimit të Brendshëm	5
- Njësia e Personelit.....	6
- Njësia e të Drejtave të Njeriut	8
- Zyra Komunale për Kthim dhe Komunitete	9
- Zyra për Riatdhesim	9
- Zyra e Prokurimit	10
- Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun	11
- Zyra e Avokatit Publik të Komunës	12
- Zyra Komunale për Integritet Evropian	13
- Zyra për Projekte	13
- Lektori	14

KAPITULLI III

Raportet e Drejtorive	15
- Drejtoria për Administratë	15
- Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim	19
- Drejtoria për Inspeksion	23
- Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë	26
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	28
- Drejtoria për Arsimit	35
- Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit	37
- Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	40
- Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi	42
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	43

HYRJE

I nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës!

Të nderuar Këshilltarë!

Kam kënaqësinë, që me ju sot të ndajë punën tonë gjatë periudhës Janar – Qershor të vitit 2019. Me respektin më të madh për Ju, sot do t'i prezantoj të arriturat e komunës për periudhën gjashtëmujore, sfidat me të cilat jemi përballë si dhe planet për gjashtëmujorin e dytë të po këtij viti. Po ashtu, më lejoni që me sinjeritetin më të madh institucional dhe qytetar t'ju falënderoj për mbështetjen tuaj gjatë punës tonë të përbashkët gjatë tërë kohës.

Një qeverisje e suksesshme është e pamundur pa bashkëpunimin e ngushtë me ju të nderuar këshilltarë si dhe me qytetarët e komunës sonë, për të cilët jemi këtu. Qeverisja jonë, përbën thelbin e një qeverisje të mirë, demokratike, transparente dhe llogaridhënëse. Më gëzon fakti, se çdo vendim dhe punë e jona deri më tani ka marrë legjitimitetin dhe konfirmimin nga qytetarët.

Unë, sinjerisht falënderoj secilin nga ju dhe çdo qytetarë të komunës sonë për mbështetjen dhe bashkëpunimin e ofruar. Mbetemi të angazhuar që ky bashkëpunim të rritet edhe më tepër, në mënyrë që puna jonë të jetë direkt e lidhur me interesat e qytetarëve dhe çdo banorë i komunës sonë të përfitoj nga puna dhe angazhimi jonë.

Puna jonë gjatë kësaj periudhe, do të ishte e mangët pa kontributin e donatorëve dhe organizatave vendore dhe ndërkombëtare, si përmes investimeve në projekte të ndryshme, ashtu edhe përmes ngritjes së kapaciteteve tona.

Të nderuar këshilltarë!

Qeveria komunale, edhe këtë gjashtëmujor ishte e përkushtuar të ofroj një jetë sa më të mirë për qytetarët e komunës sonë, të ofroj shërbime më cilësore publike, të rris kualitetin e arsimit, të ofroj shërbime më të mira mjekësore, të ndikoj në rritjen e mirëqenies së përgjithshme të qytetarëve tanë përmes investimeve direkte në bujqësi dhe përmes krijimit të një ambienti më të mirë për zhvillim ekonomik, të krijoj një ambient më të pastër për jetesë, përmes mirëmbajtjes dhe rritjes së hapësirave të gjelbra në të gjithë territorin e komunës. E gjithë kjo punë dhe angazhim është bërë përmes një bashkëpunimi të ngushtë me qytetarë, grupe të interesit dhe kategori të ndryshme.

Gjatë kësaj periudhe, është bërë punë e konsiderueshme në të gjithë sektorët, me një qëllim të vetëm që të jemi në shërbim të qytetarëve në mënyrë që të kenë një jetë sa më cilësore.

Më lejoni që të përsëris zotimin tim, se qeveria e udhëhequr nga unë, gjithnjë do të jetë në shërbim të qytetarëve të komunës sonë.

Me qëllim që të arrihet kjo, parimet udhëheqëse të qeverisë komunale kanë qenë, janë dhe do të mbesin:

- Zbatimi i panegociushëm dhe i përpiktë i kornizës ligjore që rregullon punën e qeverisë komunale
- Transparenca dhe llogaridhënia ndaj qytetarëve
- Gjithëpërfshirja e parezervë e qytetarëve, këshillave të fshatrave, organizatave dhe grupeve të interesit në çdo hallkë të vendimarrjes
- Shpenzimi racional dhe efikas i buxhetit komunal dhe parasë publike
- Zotimi, disiplina dhe përgjegjësia e çdo shërbyesi të administratës komunale në ofrimin e shërbimeve efikase për qytetarë
- Kapitalizmi i potencialit të burimeve njerëzore të komunës tonë, përmes bashkëpunimit dhe koordinimit të hapur me organizatat e të rinjve, grave, personave me nevoja të veçanta, bujqve, artistëve, sportistëve, studentëve, etj
- Bashkëpunimi i ngushtë dhe partneriteti me donator dhe organizata të huaja me qëllim të realizimit të projekteve investive në komunë
- Bashkëpunimi parimor me qeverinë qendrore, agjencionet dhe mekanizmat në nivel qendror

Këshilltarë të nderuar, dinamika e deritanishme e punëve të planifikuara, do të vazhdoj edhe më tutje, ku do të vazhdojmë që të jemi afër qytetarëve për t'i dëgjuar brengat e tyre dhe për t'i marrë me seriozitet kërkesat e tyre, në mënyrë që së bashku të bëjmë një zgjidhje në bazë të kapaciteteve që i kemi në dispozicion.

Në vijim do t'i prezantojmë aktivitetet e zyrave dhe drejtorive komunale, ku jetësimi i këtyre aktiviteteve ndikon drejtpërsëdrejti në mirëqenien e qytetarëve tanë:

KAPITULLI I

Raportet e Zyrave të Kryetarit

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB)

Në kuadër të këtij raporti të punës, Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB), për punën e vet është bazuar kryesisht në Planin vjetor të punës për vitin 2019, i cili Plan ka qenë i aprovuar nga Kryetari i Komunës së Vititë dhe nga Komiteti për Auditim të Brendshëm (KAB) në të njejtën kohë një kopje të miratuar e kemi dërguar Drejtorit të NJQHAB të Ministrisë së Financave në Prishtinë. Ndërsa bazë ligjore ka pasur Ligjin Nr.06/L-21 për KBFP. Udhëzimet administrative për auditim të brendshëm, Doracakun e auditimit të brendshëm, Statutin e auditimit të brendshëm, Instruksionet lidhur me Standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm.

Sipas Planit vjetor të NJAB-së, për vitin 2019 kanë qenë të planifikuara të kryhen gjithsejtë 7 auditime. Pikësynimi kryesor i auditimeve ka qenë kryesisht vlerësimi i funksionimit të kontrollit të brendshëm të ushtruar nga ana e drejtorëve të drejtorive komunale, lidhur me minimizimin e rreziqeve që kanë pasur të bëjnë me realizimin e objektivave të drejtorive gjegjëse, si dhe respektimin e kërkesave ligjore për të arritur një siguri të arsyeshme mbi respektimin e bazueshmërisë ligjore gjatë procesit të të hyrave, shpenzimeve, si dhe proceseve të tjera.

Për periudhën 6-mujore 2019, NJAB-i ka arritur t'i kryej 3 auditime dhe 1 auditim është në proces, pra aq sa ishin të planifikuara edhe me Planin vjetor 2019.

1. Auditimi Nr. DSHS-19/01

Tema e Auditimit: Menaxhimi i personelit në administratën komunale për vitin 2018

2. Auditimi Nr. DSHS- 19/02

Tema e Auditimit: Të hyrat nga tatimi mbi pronën e paluajtshme për vitin 2018

3. Auditimi Nr. DSHS-18/03

Tema e Auditimit: Menaxhimi i pasurive jofinanciare në administratën komunale për periudhën TM-2/2018 deri TM-1/2019

NJAB për secilin auditim të brendshëm ka dhënë të gjeturat kryesore, konkluzionet dhe rekomandimet që janë gjithsejtë për këtë periudhë gjashtë (6) mujore, trembëdhjetë (13) rekomandime të cilat janë në proces të implementimit nga ana e menaxhmentit, prandaj edhe presim që implementimi i tyre të jetë i kënaqshëm me qëllim të arritjes së objektivave të menaxhmentit të lartë të komunës për këtë vit kalendarik.

Auditimet e kryera sipas vlerësimit të rrezikshmërisë:

Në bazë të planit vjetor ne kemi planifikuar që për vitin 2019 të kryejmë shtatë (7) auditime, prej tyre tri (3) auditime janë me rrezikshmëri të lartë, tri (3) auditime janë me rrezikshmëri të mesme dhe një (1) auditim me rrezikshmëri të ultë.

Nga auditimet e planifikuara ne kemi arritur që për këtë periudhë gjashtë (6) mujore t'i kryejmë tri (3) auditime, nga këto një (2) auditim me rrezikshmëri të lartë - Të hyrat nga tatimi mbi pronën e paluajtshme për periudhën kohore 2018, ku i kemi dhënë pesë (5) rekomandime dhe Menaxhimi i pasurive jo financiare në administratën komunale, për periudhën TM-2/2018 deri TM-1/2019 ku i kemi dhënë po ashtu katër (4) rekomandime. Një (1) auditim me rrezikshmëri të ulët - Menaxhimi i personelit /Sistemi i pagave në Administratën Komunale për periudhën e vitit 2018, ku i kemi dhanë katër (4) rekomandime.

Vlerësimi i objektivave për auditime sipas shkallës së rrezikshmërisë, është bërë në Planin strategjik trevjeçar 2019 – 2021 të NJAB-së, plan ky i aprovuar po ashtu nga Kryetari i Komunës dhe nga Komiteti i Auditimit të

Brendshëm, ku një kopje e këtij Plani i është dërguar edhe Drejtorisë të Njesisë Qendrore Harmonizuese për Auditim të Brendshëm të MEF-it në Prishtinë.

Raportimet e NJAB-së dhe disa nga aktivitetet e tjera për zhvillimin e auditimit të brendshëm

Në këtë gjashtë (6) muhor të vitit 2019, përveç tjerave janë përgatitur edhe këto raporte pune të NJAB-it si:

- Raporti Vjetor i punës së NJAB për vitin 2018;
- Raporti gjashtëmuhor për vitin 2019, version i shkurtër me kërkesën e Kryetarit të Komunës.

Këto raporte i janë dorëzuar Kryetarit të Komunës, Komisionit të auditimit të brendshëm Njesisë Qendrore për Harmonizim të Auditimit të Brendshëm (NJQHAB), të gjitha janë dorëzuar brenda afatit kohor të paraparë me ligj.

- Stafi i NJAB-së, në mënyrë të veçantë ka pasur angazhime me të gjithë zyrtarët të cilët me një formë ose tjetër kanë qenë të kyçur në procesin e shpenzimeve, të hyrave dhe proceseve tjera. Përveç instruksioneve të dhëna, kemi dhënë ndihmë sidomos në të kuptuarit e drejtë të procesit të shpenzimeve, të hyrave, menaxhimit të pasurive, procesit të prokurimit etj.
- Është bërë monitorimi i seancave punuese të Kuvendit Komunal. Ky monitorim ka pas çëllim informativ për vendimmarrjet e Kuvendit Komunal, si dhe ndryshimet eventuale në legjislacionin e aplikueshëm.
- Gjatë auditimit të jashtëm, që është kryer nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), në organizatën tonë buxhetore për vitin 2018, NJAB ka dhënë një kontribut të çmuar dhe ka pasur një bashkëpunim të ndërsjellë, ku nga aktiviteti i NJAB-it i është ofruar i gjithë dokumentacioni i kërkuar si Plani vjetor 2018 dhe Plani Strategjik 2018-2020, si dhe Raporti vjetor NJAB për vitin 2018, Raporti vjetor i Komitetit të Auditimit për vitin 2018, procesverbalet e takimeve të Komitetit të Auditimit etj.
- Drejtori i NJAB mban kontakte të rregullta me Njësine Harmonizuese të AB të MEF/së, dhe përcjellë të gjitha trajnimet të cilat organizohen nga kjo NJHAB/e MEF/it.

Komiteti i Auditimit të Brendshëm (KAB):

Kryetari i Komunës, duke pasur parasysh obligimin ligjor ka të emëruar anëtarët e Komitetit të Auditimit në përbërje prej tre (3) anëtarëve dhe atë:

Komiteti i auditimit të brendshëm (KAB), ka për detyrë sipas kërkesës ligjore në fuqi, që të mbajë së paku katër (4) takime e më së shumti gjashtë (6) takime vjetore. Kryetari dhe anëtarët e Komitetit të auditimit të brendshëm (KAB), në bashkëorganizim me Drejtorin e NJAB për këtë periudhë gjashtë (6) mujore kanë mbajtur 1 takime me pikat e rendit të ditës të shqyrtuara ashtu si parashihet edhe me praktikat ma të mira për funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Njësia e personelit

Gjate periudhës kohore janar – Qershor 2019, Njësia e Personelit ka kryer punët në bazë të kompetencave dhe autorizimeve të cilat dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Ligji për Shërbimin Civil, Ligjin mbi Pagat, Ligjin mbi Administratën Shtetërore, Ligjin e Punës si dhe aktet tjera nënligjore, Statutin e Komunës dhe Vendimi mbi organizimin e organeve komunale dhe aktet tjera nënligjore të cilat rregullojnë fushën e marrëdhënies së punës.

Njësia e personelit vazhdimisht ka insistuar që të vihet rendi në administratën komunale, duke iniciuar trajnime për shërbyesit civil, me qëllim të profesionalizimit të tyre dhe të rritjes së njohurive të tyre për punën dhe disiplinën në punë. Njësia e Personelit ka bërë përshkrimin e detyrave të punës për të gjithë shërbyesit civil, konform rregullores 05/2012, rregullore kjo e cila parasheh sistematizimin gradimin e të gjithë shërbyesve civil në administratën komunale.

Njësia e Personelit, përkundër të gjitha kërkesave që janë kërkuar nga ministritë e ndryshme dhe agjencione gjithmonë me kohe ju janë dërguar edhe raportet për te cilat janë kërkuar nga agjencionet e ndryshme rreth shërbyesve civil dhe politik.

Nr.	Emri i aktit të lëshuar	Nr. i lëndëve të kryera	Vërejtje
1	Mbajtja evidencave te pushimeve vjetore me kërkesa	98	
2.	Kërkesa M.F për aprovim	11	
3.	Vërtetime mbi marrëdhënien e punës	43	
4.	Vërtetime të ndryshme për praktikantët të cilit i kanë kryer në Administratën Komunale.	3	
5.	Shpallje të konkurseve	11	
6.	Formular mbi pagat	16	
7.	Formular për punëtor të rinj	11	
8.	Formular për ndryshime	13	
9.	Formular për pagesa retroaktiv	0	
10.	Intervistim me shkrim	11	
11.	Intervista me gojë	11	
12.	Përshkrimi i vendeve të punës	11	
13.	Fletëparaqitje disiplinore te bëra nga përgjegjësit kompetent	0	
14.	Ankesa te shërbyesve civil dhe qytetarëve	6	
15.	Kontrata me SH,V. për 4 muaj	6	
16.	Kompletim i dosjeve personale	43	
17.	Dërgimi i formularëve për deklaram te pasurisë për te gjithë këshilltaret	49	
18.	Formular për ndryshime për ndërrim te llogarive rrjedhëse	27	
19.	Vendime për Punëtorë të pensionuar parakohshëm	0	
20	Aktemërimet	11	
21	Vendim për largim nga puna ME VDEKJE	1	
22	Vendim për pensionim të pleqërisë	3	
23	Anulim te konkursit	3	
24	Lëshime te vendimeve për te pensionuarit-Kompensim një page.	3	
25	Kërkesa për MAP për shpallje të konkursit	15	
26	Kërkesë për pagë jubilarë MAPL	7	

27	Raporte për MAP- 3mujorshe	2	
28	Përgjigje ne ankesë KPMK	8	
29	Përgjigje në informata të kërkuara nga KPMK	5	
30	Vendime të pushimeve të lehonisë	1	
31	Vendime për rifillim te punës	1	
32	Numri i përgjithshëm për vlerësimet e punës të shërbyesve civil	136	
33	Transfer prej KK.Viti ne Prishtinë	1	
34	Vendim te pensionimit te parakohshëm	2	
35	Vendim pa pagese për tre muaj	1	
36	Vendim ne kthim nga Gjykata e Apelit	1	

Tab.1. Gjithsej lëndë të kryara,522

Njësia e të drejtave të njeriut

Në raport janë prezantuar aktivitetet të cilat pasqyrojnë dhe reflektojnë angazhimin dhe rezultatet e shënuara përgjatë periudhës janar – qershor 2019, ku prej tyre veçojmë:

- Takime dhe tryeza me shoqërinë civile, OJQ-të, komunitetin e të rinjve për implementimin e ligjeve të aplikueshme në funksion të të barazisë gjinore (2 takime);
- Përgatitja dhe shpërndarja e fletëpalosjes “Njih të Drejtat” – prezantimi i të drejtave për trashëgiminë dhe pronën, konform ligjeve në fuqi, gjegjësisht LTK-së;
- Analiza gjinore dhe përgatitja e buxhetimit gjinor në kategoritë ekonomike: paga mëditje dhe subvencione;
- Sigurimi i të dhënave statistikore nga këto sfera:
 - zhvillim ekonomik;
 - punësim / mirëqenie sociale;
 - shëndetësi;
 - procesin e vendimmarrjes.
- Organizimi i trajnimit dhjetë ditor me 12 shoqata të grave, me temë “Trashëgimia pronësore e grave”, ku nga këto trajnime kanë përfituar 180 femra (organizuar nga GLV Vitia dhe Ministria e Bujqësisë);
- Dhënia e rekomandimeve në fushën e barazisë gjinore në përgjithësi për aktet normative komunale të aprovuara në KK përgjatë periudhës raportuese (harmonizimi i tyre me ligjet që janë në funksion të barazisë gjinore);
- Organizimi dhe mbajtja e ligjëratave në shkollat e komunës së Vitisë për parandalimin e ngacmimeve seksuale dhe keqpërdorimin e rrjeteve sociale, ku përfitues nga këto ligjëratë ishin nxënësit e shkollave e mesme të ulëta të Komunës së Vitisë;
- Realizimi i projektit “ Transformimi i mundësive ekonomike të grave” në partneritet me organizatën Partners Kosova (projekt trevjeçar), ku është bërë ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve komunal përmes trajnimeve në fushën e barazisë gjinore;
- Fuqizimi ekonomik i grave (bizneseve për vetëpunësim) përmes ndarjes së garantëve për zhvillimin e bizneseve (biznese për përpunimin e ushqimit);
- Hartimi i Strategjisë për parandalimin e dhunës në familje dhe plani i veprimit 2019-2023 (në proces të hartimit);

- Bashkëpunimi me Avokatin e Popullit për të pranuar ankesat e qytetarëve të Komunës së Vitisë për shkelje të të drejtave të njeriut nga institucionet, si dhe aktivitete tjera kontinuele.

Zyra komunale për Kthim dhe Komunitete

- Funksionon në përputhje me legjislacionin sekondar-rregulloren Nr. 02/2010 për Zyrat Komunale Për Komunitetet dhe Kthim.
- Komunitetet, në përputhje me Ligji Nr. 03/L-047, përkufizohen si grupe kombëtare, etnike, kulturore, gjuhësore apo fetare tradicionalisht të pranishme në Republikën e Kosovës të cilat nuk janë shumicë.
- Komuna e Vitisë, përmes kësaj zyre, mbron dhe promovon të drejtat e komuniteteve, siguron që të gjitha komunitetet të kenë qasje të barabartë në shërbimet publike si dhe krijimin e kushteve për kthim të qëndrueshem të refugjatëve, personave të zhvendosur dhe personave të riatdhesuar.
- Aktivitetet e kësaj zyre, në vazhdimësi, dhe gjatë kësaj periudhe raportuese, janë fokusuar në ofrimin e Këshillave dhe bashkebisedime me pjesëtarët të komuniteteve duke promovuar të drejtat e tyre në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- Lista e aktiviteteve:
- Më 2019/01/29, është mbajtur takimi i Komitetit për Komunitete të Komunës së Vitisë. Nga kjo mbledhje është miratuar planin vjetor të punës.
- Më 28/02/2019- është mbajtur takimi i -II-të i Komitetit për komunitete. Pjesa më e madhe e diskutimit ka qenë në lidhje me pikën e dytë të rendit të ditës, mbi transportin tregtar të përbashkët ndërmjet kumunave të Klllokoti dhe Parteshit e cila do të jetë në funksion të lehtësimit të jetës së qytetarëve të këtyre lokaliteteve.
- Me 04.03.2019, është mbajtur seminari "Sfidat dhe praktikat më të mira në zbatimin e ligjit të ri për tatimin në pronë"
- Ky seminar ka qenë i organizuar nga OSBE-ja në hotelin "Emerald" në Prishtinë. Më 03.04.2019 është mbajtur Takimi i 3-të i Komitetit për Komunitete. Komiteti ka diskutuar dhe ka arritur një vendim unanim për të ndihmuar komunitetin kroat në formën e pakove me ushqime bazë për çdo familje.
- Gjithashtu, është mbajtur një sesion trajnimi për anëtarët e komisionit komunal për kthim. Seminari është mbajtur në restorant "Evropa 92". Trajnimi është mbështetur financiarisht nga OSBE-ja, me një pjesëmarrje nga përfaqësues të Ministrisë për Kthim dhe Komunitete, si dhe anëtarë të OIQ-ve.
- Më 06/06/2019, është mbajtur, Punëtorja, Ndërtimi kapaciteteve për të rritur efikasitetin e mekanizmave për mbrojtjen e komuniteteve e organizuar OSBE.

Zyra për Riatdhesim

Gjatë kësaj periudhe kohore janë kryer këto aktivitete:

- Janë riatdhesuar:
 - Nga Gjermania:
 - Me familje: dy familje, njëra me 4 anëtarë (bashkëshortët dhe dy fëmijë ,djem) dhe tjetra me 6 anëtarë (bashkëshortët dhe 4 fëmijë, tri vajza dhe një djalë)
 - Pa familje: 7 persona
 - Nga Franca:
 - Me familje- Një çifte bashkëshortor
 - Pa familje -1 person
 - Nga Zvicra:
 - Me familje-S'ka
 - Pa familje-1 person

Nga Shtetet tjera: S'ka
Gjithsej të riatdhesuar 21 persona

- Ndhimë-Përfitues sipas rregullores 13/2017 janë:
Një familje me 4 anëtarë (banim përmes qeras 2 herë nga gjashtë muaj)
- Kërkesa 1
- Përgjigje 1
- Vërtetim mbi bazën e dëshmimeve 1
- Me formular të riatdhesimit janë pajisur 10 persona, kërkesa kryesisht për kompletim të dokumentacionit që iu është kërkuar palëve nga Zyryja e Komunale e Punësimit
- Komisioni Komunal për Riintegrim dhe Riatdhesim ka mbajtur një takim
VENDIME-vetëm një VENDIM për banim përmes qerasë(dy herë nga gjashtë muaj)
- Janë monitoruar rastet që ishin për monitorim në bashkëpunim: ZKKK, ZKK-ja Regjionale dhe Zyryja Komunale e Punësimit
- Bashkëpunim me organizatat si: CRP/K-Programi për të Drejtat Civile në Kosovë, Partners Kosova, AEO-ja (Organizatë që ndihmon të riatdhesuarit nga një regjion i Gjermanisë me seli në Nyrberg)
- Bashkëpunim dhe takime (dy takime pune) me Karitasin Zvicerran, njëri takim me Zyren Komunale të Punësimit dhe tjetri me QPS-programi SUREP (kthimi i qëndrueshëm i personave të riatdhesuar përmes RIINTEGRIMIT socioekonomik)
- Takime pune në MPB
- Letër drejtoreshës së Karitasit Zvicerran, përmes Kryetarit të Komunës, për mundësinë e një marrëveshjeje bashkëpunimi

Zyra e Prokurimit

Raport ka të përmbledhur aktivitetet e prokurimit të zhvilluara për ofrimin e shërbimeve, zhvillimin e punëve dhe furnizimeve që janë domosdoshmëri për plotësimin e nevojave të komunës, bazuar në kërkesën e njësive shpenzuese dhe për realizimin e shpenzimeve buxhetore, si dhe për plotësimin e kërkesave të njësive buxhetore dhe mbarëvajtje pa pengesa të aktiviteteve të komunës, si dhe për realizimin e investimeve kapitale të planifikuara në interes të komunitetit dhe mirëqenjes qytetare në përgjithësi, këto aktivitete zyra i zhvillon, bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik. Bazuar në këtë, Zyra e prokurimit ka përgatitur këtë Raport për aktivitetet e prokurimit 6 mujor për vitin 2019, në të cilin janë të përfshirë aktivitetet e realizuara të prokurimit dhe aktivitetet tjera të cilat janë në procedurë e sipër, ku përfshihen në këtë gjashtëmujor

Në gjashtë mujorin e vitit 2019, duke u bazuar në kërkesat e njësive shpenzuese zyra ka inicuar 42 aktivitete të prokurimit. Duke i ndarë ato sipas kategorive ose llojit të ndara në punë, shërbime dhe furnizime, kemi këto të dhëna; 7 aktivitete me lëndë prokurimi Shërbime, 15 aktivitete me lëndë prokurimi Punë dhe 20 me lëndë prokurimi Furnizime. Nga këto aktivitete, 27 janë permbyll si aktivitete, tjerat janë në procedurë. Ndërsa lloji i procedurave e udhëhequra janë si vijon: 31 raste është përdorë procedura e hapur, 8 raste procedura e kuotimit i çmimit dhe 3 aktivitete procedurë me vlera minimale. Prej këtyre aktiviteteve të zhvilluara 27 aktivitete të prokurimit janë permbyll dhe janë finalizuar me nënshkrimin e kontratave, ndërsa 14 aktivitete të prokurimit janë në zhvillim apo procedim të mëtutjeshëm.

Zyra e Prokurimit, përveç këtyre aktiviteteve ka realizuar edhe pagesa për Operatorët Ekonomik që kanë kryer punë, furnizime apo shërbime sipas kontratave që kanë me komunën tonë. Shuma e përgjithshme e shprehur në vlerën e kontratave të lidhura është 2.695,296.47 €.

Zyra e Prokurimit, gjatë kësaj periudhe kohore ka lëshuar **566 urdhërblerja** për pagesën e OE të kontraktuar, duke udhëhequr lëndët për kompletim dhe janë dërguar në Thesar për pagesë, gjegjësisht ekzekutim. Zyra e Prokurimit ka kryer edhe 80 rekomandime për vendimet e ndryshme të komisioneve për hapje dhe vlerësim dhe komisioneve tjera.

Gjithashtu duhet potencuar, se Zyra e Prokurimit në gjashtëmujorin e parë, ka kryer punë dhe shërbime të ndryshme sipas kërkesave dhe nevojave të të gjithë njësive shpenzuese, duke ofruar këshillime dhe shërbime profesionale, me qëllimin e mbarëvajtjes së punëve në komunë dhe respektimin dispozitave ligjore në fuqi.

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

Gjatë vitit 2019, respektivisht periudhës janar-qershor, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun e Komunës së Vitisë, ka qenë e angazhuar në informimin sa më objektiv dhe të shpejtë për zhvillimet aktuale të Institucioneve komunale. Gjatë kësaj periudhe, janë organizuar takime me media, janë përcjell mbledhjet e bordit të drejtorëve, aktivitetet e kryetarit të komunës, solemnitete e manifestime si dhe përrurime projektesh nga terreni i komunës sonë për të njoftuar publikun e gjerë për zhvillimet e gjithmbarshme në komunën e Vitisë. Gjitha këto ngjarje, janë pasqyruar në publikim në Web faqen e komunës kk.rks-gov.net/viti si dhe në adresën e komunës së Vitisë në rrjetin social Facebook.

- Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, gjatë kësaj periudhe ka publikuar 78 dokumente mbi procedurat e konkurrimit dhe pranimit në punë si dhe 68 dokumente mbi procedurat e prokurimit publik si: Kontratat e Nënshkruara, Njoftime për Kontratë, Njoftime për dhënie të Kontratës, Planet dhe Raportet e Prokurimit Publik;
- Janë publikuar gjithashtu edhe 56 Njoftime publike, 30 Vendime të Kuvendit Komunal, 18 Vendime të Kryetarit të Komunës, të gjitha draft dokumentet të cilat janë paraparë të shqyrtohen në Komitetin për Politikë e Financa dhe Kuvendin Komunal;
- Kemi harmonizuar dhe funksionalizuar webfaqën në gjuhën serbe;
- Po ashtu janë publikuar edhe disa Plane e Raporte si dhe Dokumentet të cilët ndërlidhën me shpenzimin e parasë publike;
- Një bashkëpunim të ndërsjellët dhe shumë të mirë, kemi pasur me mediat lokale dhe ato qendrore. Përmes adresave elektronike, gjitha mediave të shkruara, elektronike dhe agjencive të lajmeve u janë dërguar lajmet për ngjarjet nga komuna e Vitisë edhe përmes fotografive;
- Zyra për Informim publik ka përcjell gjitha aktivitetet e kryetarit të komunës, apo edhe zyrtarëve të tjerë komunal në terren;
- Pritjen e delegacioneve vendore dhe të huaj në komunën tonë;
- Zyra për Informim Publik, ka përcjell gjitha seancat e Kuvendit Komunal, ku është përkujdesur për teknikën e zërimit në sallë si dhe ka bërë incizimin e mbledhjeve në formë tonike për Sekretarinë e Kuvendit;
- Zyra për Informim Publik ka përcjell edhe gjitha mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa për të cilat ka njoftuar edhe gazetarët;
- Seancat e Kuvendit janë incizuar dhe transmetuar në mediat lokale na bazë të kontraktimit me to dhe Zyra për Informim i ka monitoruar gjatë transmetimit;
- Në kuadër të zyrës janë bërë specifikimet e shpenzimeve për publikime: Shpallje, Konkurse, tenderë, Njoftime etj;
- Ndërkaq në kuadër të punës së Zyrës për Informim Publik, edhe pse ende vazhdojnë të vijnë kërkesa për qasje në dokumente publike janë pranuar dhe shqyrtuar 35 Kërkesa për Qasje në Dokumentet Publike.

- Zyra për Informim ka marrë pjesë pothuajse në të gjitha trajnimet, punëtorit dhe mbledhjet e ndryshme për ndryshimin e pakos ligjore për Transparencë dhe është në fazën e finalizimit të ndryshimit të Rregullores për Transparencë si dhe të hartimit të Planit të Veprimit për Transparencë për periudhën 4 vjeçare
- Gjithashtu Zyra për Informim konkretisht Koordinatori Komunal për performancë, ka ndjekur të gjitha trajnimet lidhur me SMPK dhe janë të gatshëm të fillojnë me procesin e raportimit.

Zyra e Avokatit Publik të Komunës

Avokati publik i Komunës funksionin e vet e kryen në bazë të Kushtetutës dhe Ligjeve të aplikueshme të Republikës së Kosovës, si dhe në bashkëpunim me të gjitha instancat gjyqësore. Avokati publik i Komunës e përfaqëson Komunën në të gjitha instancat gjyqësore, duke filluar nga Gjykata themelore e deri në Gjykatën Kushtetuese në kontestet gjyqësore qofshin ato penale apo civile. Avokati publik përfaqëson Komunën në të gjitha fazat, për të gjitha çështjet kontestuese ,për të cilat Komuna na paraqitet si palë ndërgjyqësore.

Për vitin-kohën tani për të cilën po raportojmë janar- Qershor 2019, avokati publik i Komunës ka kryer këto punë:

Lëndët e regjistruara gjyqësore për vitin-kohën për të cilën tani që po raportojmë, të të gjithave procedurave gjyqësore janë **31 lëndë të regjistruara**, **18** lëndë janë lëndë nga procedura civile në procedurë kontestimore të natyrave të ndryshme, **3** lëndë janë të procedurës jashtëkontestimore, **10** lëndë janë të procedurës penale, për të cilat lëndë janë ushtruar kallzime penale, të cilat sipas detyrës zyrtare I udhëheqë prokurori i shtetit.

Prej lëndëve kontestimore në procedurën civile të cilat në numër janë **18**, ku avokati kundër këtyre lëndëve ka ushtruar **11**, përgjigje në padi, kundër paditësve dhe 7 padi të gjitha këto lëndë janë duke u zhvilluar në procedurë gjyqësore. Ndërsa nga lëndët e bartura nga vitet paraprake të cilat janë ende në procedurën prej këtyre lëndëve të bartura për të cilat janë mbajtur shumë seanca gjyqësore me vite në këtë periudhë që tani po raportojmë janë përfunduar me aktvendim, aktgjykim, të formës së prerë nga Gjykata e Apelit e R. së Kosovës dhe nga Gjykata Supreme e Kosovës me mjete të jashtëzakonshme me Revizion janë përfunduar **5** lëndë në favor të komunës së Vitisë, ku vlera e tyre është 100.000 mijë €. Ndërsa 18 lëndët kontestimore civile të cekura më lartë për periudhën tani që po raportojmë, janar qershor për 2019 këto lëndë janë të gjitha në procedurë gjyqësore, janë në procedurë, disa janë duke u zhvilluar me mjete juridike të **rregullta**, me ankesë ku kemi ushtruar 6 ankesa, disa janë në procedurën e përmbarimit, ku kemi 14 prapësime dhe si dhe mjete të **jashtëzakonshme** në instancat më të larta gjyqësore. Ndërsa 10 lëndët penale për veprat penale për uzurpime të pronës komunale-shtetërore nga neni 332 parag.1 i KPRK-ës, që sipas detyrës zyrtare i udhëheq Prokurori i Shtetit të gjitha këto janë në procedurën e shqyrtimit gjyqësorë , ndërsa lëndë penale të bartura nga vitet paraprake në vitin 2018 për të cilin po raportojmë janë përfunduar me aktgjykim të formës së prerë 3 lëndë siç e cekem edhe më lartë.

Për periudhën që tani po raportojmë, Avokati publik ka pranuar nga gjykatat tona edhe 6 lëndë kontestimore me padi, ku paditësit janë punëtorët e pensionuar gjatë viteve paraprake, ku të njëjtit me kërkesëpadi kërkojnë pas pensionimit edhe nga 6 paga, tri paga jubilarë dhe tri paga përcjellëse pas pensionimit, duke u bazuar në marrëveshjen kolektive të vitit 2014, e cila ka hyr në fuqi janar 2015. Meqenëse Komuna e Vitisë nuk ka mjete të ndara nga Qeveria e Kosovës për këto pagesa pas pensionimit të punëtorëve të saj, andaj Avokati i Komunës, duke u bazuar në këto arsye ne kemi ushtruar 6 përgjigje në padi të natyrës së këtillë, duke i kundërshtuar nga arsyet e sipërcekura, ku të gjitha këto lëndë janë në procedurë gjyqësore. Lëndët civile që kanë të bëjnë me kontestet e punës të regjistruara janë 2, lëndë e që janë në procedurën gjyqësore ku Komuna e Vitisë paraqitet si paditëse në Gjykatën themelore në Prishtinë –departamenti administrativ. Ndërsa lëndët që I përkasin procedurës jashtëkontestimore, që fillojnë me propozim, të cilat kanë të bëjnë me gjetjen - rregullimin e sinorëve - me xhave tokësore të paluajtshmërive, për kohën që po raportojmë fatmirësisht nuk kemi (-)

Sa i përket mjeteve të jashtëzakonshme, Revizioni, Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe propozimi për përsëritjen e procedurës, qoftë në procedurë penale, apo civile, të cilat ushtrohen vetëm kundër aktvendimeve, aktgjykimeve të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, Komuna e Vitisë për këtë që po raportojmë ka ushtruar 2 revizione 1 përgjigje në revizion për të cilat ende nuk kemi vendime, aktgjykime nga Gjykata Supreme e R. së Kosovës. Meqenëse nëpër gjykatat tona ka shumë lëndë të viteve paraprake të cilat kërkojnë zgjidhje, ende nuk janë treguar edhe përkundër disa parashtrësive të ushtruar nga avokoti i komunës për disa lëndë të cilat janë me prioritet por ende nuk kemi ftesa për shqyrtim kryesor.

Avokati publik i Komunës përveç punëve që kryen në bazë të përshkrimit të vendit të punës, kryen edhe punë tjera shtesë të cilat i delegohen nga Kryetari i Komunës.

Zyra Komunale për Integritet Evropian

Zyra Komunale për Integritet Evropian, zyrtari për integritet evropian gjatë periudhës Janar – Qershor 2019 ka kryer këto aktivitete:

1. Kemi profilizuar Planin Kombëtar për Integritet Evropian 2019 dhe iu ka rekomanduar Zyrës së Kryetarit të Komunës, Zyrës së Kryesuesit të Kuvendit, drejtorive komunale dhe zyrave ndihmëse të Kryetarit të Komunës, për plotësimin e objektivave që dalin nga Planin Kombëtar për Integritet Evropian 2019;
2. Kemi mbajtur takim njoftues me Zyrën e Kryetarit të Komunës, Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit, drejtoritë komunale dhe zyrat ndihmëse të Kryetarit të Komunës;
3. Kemi marrë pjesë në Raportin e parë për financimin publik të OSHC-ve, në Republikën e Kosovës;
4. Kemi marrë pjesë në takimin e Kolegjiut të ZKI-ve, me AKK dhe MAPL-në;
5. Kemi përcjell punimet e takimeve të KPF-së;
6. Kemi përcjell punimet e seancave të Kuvendit të Komunës;
7. Kemi marrë pjesë në komisionin për riintergrim, në bordin e drejtorive;
8. Kemi udhëhequr me komisionin për hapjen e kutive të ankesave, si dhe një varg aktiviteteve të ndryshme të organizuar nga Kryetari i komunës dhe drejtoritë përkatëse.

Zyra për Projekte

Bazuar në detyrat e punës nga Zyra e Kryetarit të Komunës dhe kërkesat e zyrës së projekteve gjatë periudhës janar- qershor - të vitit 2019, kemi punuar në hartimin e projekteve, raporteve të pranimi të tyre dhe mbikëqyrjes së zbatimit të projekteve.

Përveç hartimit të projekteve të lartpërmendura, kemi kryer edhe këto punë si:

- hartimin e detyrave projektuese
- Pranimin teknik të hartimit të projekteve të ndryshme
- Pranimin teknike të projekteve të përfunduara
- Komisione të ndryshme për vlerësim
- Menaxhimi i zbatimit të projekteve
- Angazhime tjera shtesë sipas kërkesave të menaxhmentit

Lektori

Gjatë periudhës kohore Janar - Qershor 2019, si lektor Administratës së Komunës dhe i Kuvendit të Komunës së Vitisë, kam kryer punë dhe detyra të punës sipas përgjegjësisë zyrtare dhe përshkrimit të detyrave të vendit të punës. Kam lekturuar dokumente zyrtare për Zyrën e Kryetarit, për Kuvendin e Komunës, për drejtoritë, për njësitë dhe zyrat komunale etj.

Gjatë periudhës kohore Janar – Qershor 2019 kanë lekturuar këto dokumente:

1. Informata vjetore e Kryetarit të Komunës me drejtorit komunale 2018; vendime, fjalime
2. Konkursët e DKA-së, si: konkurs publik 11.01.2019; lista e kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkurs 11.01.2019; Konkursët për regjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme të Vitisë, 21.06.2019 (3); Njoftim 04.02.2019; raporti vjetor 2018.
3. Propozim rregullorë për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunal miqësor për fëmijët dhe Propozim rregullorë për themelimin dhe strukturimin e asamblesë komunale të fëmijëve; Propozim rregullorë për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së subjekteve të biznesit në Komunën e Vitisë; Propozim vendim për shpalljen në diskutim publik për propozim rregullorë për mënyrën dhe kushtet e menaxhimit dhe shfrytëzimit të objekteve dhe fushave sportive publike
4. Vendimet e DSHPE-së, si: 20.06.2019.
5. Procesverbalet e Këshillit të Drejtorëve, procesverbali I, II.
6. Procesverbalet e Kuvendit Komunal, procesverbali XII-2018, I, II, III, IV, V. Vendimet e Kuvendit: 27.02.2019, 28.02.2019(9), 28.03.2019(7), 21.04.2019(2), 30.04.2019(10), 31.01.2019(6), 03.06.2019(5); deklaratë 18.03.2019; letërrekomandim 17.04.2019
7. Procesverbalet e KPF-së, procesverbal XII-2018, I, II, III, IV, V.
8. Procesverbalet e KKSBB-së, mbledhja XII-2018, I, II.

Gjithashtu kam ndihmuar edhe gojarisht zyrtarët sipas ndonjë kërkesë me gojë që më është shtruar dhe kam kryer punë shtesë.

KAPITULLI II

Raportet e Drejtorive

Drejtoria për Administratë

Misioni i Drejtorisë për Administratë është zbatimi Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, ligjeve tjera që aplikohen në Administratë, Udhëzimet Administrative të nivelit qendror, Statutit të Komunës së Vitisë dhe akteve tjera komunale të aprovuara nga Kuvendi i Komunës.

Drejtoria e Administratës, kryen shërbime të përgjithshme administrative për organet e administratës dhe ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarët e Komunës së Vitisë.

Shërbimet e përgjithshme administrative për organet administrative dhe organet tjera të kësaj drejtorie përfshijnë:

- Ofrimi i shërbimeve dhe kryerja e punëve administrative mbështetëse për punën e Kuvendit të Komunës, trupave të Kuvendit të Komunës dhe Këshillit të Drejtorëve.
- Përgatitja e akteve të cilat i nxjerr Kryetari i Komunës, Këshilli i Drejtorëve.
- Harton propozim rregullore, propozim vendime në fushën e Administratës,
- Kujdeset për përktimin e materialeve të Kuvendit, trupave të kuvendi dhe Këshillit të drejtorëve duke respektuar gjuhët zyrtare.

Drejtoria e Administratës, ka realizuar objektivat të cilat dalin nga Plani i Punës së Drejtorisë për vitin 2019.

Drejtoria për Administratë ka hartua planin e veprimit për muajt Janar dhe Qershor 2019 për arsye të kryerjes së shërbimeve administrative për bashkatdhetarët që vijë nga bota e jashtme për pushime veror.

Në vazhdim do të paraqesim punën e sektorëve të kësaj drejtorie.

I. Sektori për punë administrative

Sektori për punë administrative ka kryer punët dhe detyrat e punës për nevojat e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Kryetarit të Komunës, Këshillit të Drejtorëve dhe drejtorit të Drejtorisë për Administratë.

Ky sektorë ka përgatit ftesat dhe materialet tjera për mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete, Këshillit të Drejtorëve, Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, etj. Kuvendi i Komunës ka mbajt 5 seanca të rregullta të jashtëzakonshme nuk ka, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajt 6 mbledhje të rregullta. Komiteti për komunitete ka mbajt 5 mbledhje dhe Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka mbajt 4 mbledhje të rregullta.

Kuvendi i komunës ka miratua: 0 rregullore dhe 0 plotësim-ndryshim të rregullores, dhe 36 vendime të ndryshme. Të gjitha këto akte normative të Kuvendit janë përgatit për procedurë për nënshkrim dhe protokollim dhe janë dërguar në Ministrinë për Administrimin e Pushtetit Lokal për vlerësim të ligjshmërisë së këtyre akteve. Janë përgatit 6 procesverbale të seancave të Kuvendit të Komunës, 6 procesverbale të Komitetit për Politikë dhe Financa, 5 procesverbale të Komitetit për Komunitete, dhe 4 procesverbale të KKSBB, 0 procesverbale të seancave solemne, 0 procesverbal i seancës së jashtëzakonshme.

Gjatë kësaj periudhe raportuese Këshilli i Drejtorëve ka mbajt mbledhje konsultative javore dhe mbledhje të rregullta ku janë shqyrtuar materiale të ndryshme të cilat janë përcjellë për shqyrtim dhe aprovim në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin Komunal. Për mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve është përgatit materiali si dhe janë hartua procesverbale për këto mbledhje.

Për nevojat e Kryetarit të komunës për këtë periudhë raportuese janë hartuar gjithsejtë 241 dokumente. Prej tyre 26 vendime, 13 marrëveshje të ndryshme, kërkesa dhe shkresa të ndryshme. Dokumentet e hartuara janë të natyrave të ndryshme: Propozim vendime për kuvend, të ndarjes së ndihmave financiare, vendime për formimin e

komisioneve të ndryshme për pranimin e mallit, vendime për caktimin e menaxherit për mbikëqyrjen e punëve, vendime për pranimin teknik të punëve etj.

Zyrtari për përkthim ka përkthyer në mënyrë simulantë në të gjitha mbledhjet e Kuvendit, Komitetit për Politikë dhe Financa, Këshillit për Siguri në Bashkësi, Komitetit për Komunitete dhe Këshillin e Drejtorëve. Gjithashtu ka përkthyer edhe të gjitha materialet të cilat kanë dal nga mbledhjet e Kuvendit, KPF, KKSBB, Komitetit për Komunitete dhe Këshilli i Drejtorëve.

II. Sektori i gjendjes civile

Në vazhdim po e paraqesim numrin e dokumenteve të lëshuara nga Sektori i Gjendjes Civile për periudhën Janar –Qershor 2019:

Nr	Përshkrimi i Lëndëve	totali
1	Ekstrakt Lindje	10149
2	Çertifikata Lindjes	6150
3	Çertifikata martesës	2658
4	Çertifika e Vdekjes	844
5	Çertifikata Vendbanimi	503
6	Çertifikata e Bashkësisë familjare	2940
7	Çertifikata e Statusit Martesor	407
8	Çertifikata e Shtetësisë	357
9	Vërtetim nga Arkivi	675
10	Vendimet	132
11	Aktvdekjet	86
12	Vërtetim i Mjeteve	59
13	Vizita	15
14	Regjistrimet në LAL të jashtme	132
15	Regjistrimet në LAL të brendshme	4
16	Regjistrimet në LAV (vdekje të jashtme)	1
17	Regjistrimet në LAV (vdekje të brendshme)	116
18	Regjistrimet në LAM të jashtme	79
19	Kurorëzime të reja	243
20	Shkurorëzime	24
21	Humbje Shtetësisë	29
22	Fitim Shtetësisë	3
23	E- kiosku	39
	Totali i dokumenteve të lëshuara	25645

Tab.2. Dokumentet e lëshuara nga Sektori i Gjendjes Civile

Numri i përgjithshëm dokumenteve të lëshuara për periudhën Janar – Qershor 2019 është 25.645 dokumente, verifikimi në sistemin e Gjendjes Civile, qytetar të futur në sistemin e Gjendjes Civile janë 52.253

Vërejtje: Efikasiteti dhe azhuriteti i punës të sektorit të gjendjes civile kishte me qenë edhe me i madh po të mos mungonte hapësira e nevojshme për punë.

III. Sektori i Zyrës Pritëse dhe Arkivit

Zyra Pritëse, në kuadër të aktiviteteve të saj të cilat i ka kryer për këtë periudhë raportuese për vitin 2019 janë si: regjistrimin e të gjitha kërkesave dhe parashtrësive, shërbimet postare për organet e administratës komunale, ofrimin e ndihmës juridike qytetarëve për plotësimin e kërkesave, dhe regjistrimin e kërkesave në protokoll.

Numri i kërkesave të pranuar në zyrën pritëse është paraqit në formë tabelare.

Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Vdekurve -L.A.V nga jashtë	10
Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Martuarve -L.A.M nga jashtë	55
Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Lindurve -L.A.L nga jashtë	130
Kërkesa për regjistrim në LAV brenda vendit	78
Deklarata për vendqëndrim	0
Deklarata për trashëgimi	85
Deklarata për përkujdesje financiare	56
Deklaratë për regjistrimin në LAL	10
Deklarata për regjistrim në LAV	48
Gjithsejtë:	472

Tab.3. Numri i kërkesave të pranuar në zyrën pritëse

LËNDËT E ARKIVUARA

Drejtoria	Nr. i lëndëve të arkivuara
Drejtoria për Shërbime Publike dhe Siguri	136
Drejtoria për Administratë	22,226
Drejtoria për Arsimit	360
Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	56
Drejtoria për Financa Ekonomi, dhe Zhvillim	4,298
Drejtoria për Kulturë , Rini dhe Sport	236
Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mjedisit	82
Drejtoria e Inspeksionit	61
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	666
Drejtoria për Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër	3,830
Kuvendi i Komunës	11
Zyra e Kryetarit	241
Zyra për Komunitete	2
Totali	32,205

Tab.4. Lëndë të arkivuara

IV. Sektori i administrimit

Ky sektor përfshin shërbimet që kanë të bëjnë me mbështetjen logjistike të organeve të administratës dhe atë: Kujdesit për mirëmbajtjen e auto veturave zyrtare të organeve të administratës, sigurimin dhe mirëmbajtjen e objekteve komunale.

Vërejtje: Për punë më efikase dhe menaxhim me te suksesshëm në këtë sektor, duhen te bëhet renovimi i objekteve komunale, autoparkut dhe krijimin e hapësirave të nevojshme për punë.

Në vazhdim po i prezantojmë shpenzimet e mirëmbajtjes, karburanteve dhe shpenzime tjera për automjete dhe gjeneratorë për periudhën Janar – Qershor 2019.

Shpenzimet e mirëmbajtjes së automjeteve dhe gjeneratorëve për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë për periudhën raportuese janë 7,345.00 euro.

- Administrata.....2,852.00€,
- Shëndetësia 2,308.00€ dhe
- Njësia e zjarrfikëseve..... 2,185,00€

Shpenzimet për derivate të naftës për automjete, gjenerator, nxehje qendrore dhe autorizime për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë janë 28,131 litra.

Shpenzimet për derivate të naftës për automjete, për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë janë: 18.641 litra

- Administrata.....9.571 litra,
- Shëndetësia5.578 litra dhe
- Njësia e zjarrfikës.....3.492 litra.

Shpenzimet për derivate të naftës për nxehje qendrore për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë janë 8.500 litra naftë,

- Administrata..... 7.500 litra
- D. Kulturës..... 0
- Shëndetësia1.000 litra,
- Njësia e zjarrfikësve..... 0 litra.

Shpenzimet për derivate të naftës për gjenerator për të gjitha njësit shpenzuese janë: 990 litra.

- Administrata..... 814 litra,
- Shëndetësia..... 28 litra,
- Njësia e zjarrfikësve..... 148 litra.

Zyra e IT-së

Zyra e IT-së ka udhëhequr dhe kontrolluar punën e sistemit të teknologjisë informative me qëllimin e zbatimit të standardeve dhe ofrimin e shërbimit më cilësor, në veçanti:

- Ka zbatua hardëare, Softëerin Kompjuterik dhe të qasjes me internet
- Mirëmbajtjen e infrastrukturës për internet dhe kyçje sipas nevojave të ndryshme për organet komunale.

Për periudhën 03.01.2019 e gjerë më 30.06.2019

Nr.	Emërtimi	Nr. Intervenimeve	Vërejtje
1	Risetimi password të Domenit	60	
2	Hapja e Userave të Domenit	20	
3	Hapja e Userave të Intranetit	18	
4	Intervenimet në Usera	65	
5	Intervenimet në rrjetin qeveritar	20	
6	Intervenimet në programe	45	
7	Konfigurimi i swigrit	0	
8	Intervenimet në Gjendjen Civile	10	
9	Intervenimet në Tatimin Pronë	10	
10	Futja e kompjuterëve në Domen	30	
11	Instalimi i software	40	

12	Instalimi i computer hardware devices	30	
13	Rregullimi kablllove të internetit	30	
14	Intervenimet në E-mail	100	
15	Hapja E-mail Zyrtar të reja për zyrtar Komunal	25	
16	Intervenimet në Intranet	30	
17	Monitorimi i Kuvendit përmes Teleprezencës	0	
18	Drejtoria Arsimit	10	
19	Qendra për punë sociale	22	
20	Telefonave VOIP	5	
21	Skanimi kompjuterëve nga viruset	15	
	Gjithsejtë	585	
1. Mirëmbajtja e Serverit çdo ditë 2. Mirëmbajtja e Intranetit çdo ditë 3. Mirëmbajtja e Gjendjes Civile çdo ditë 4. Mirëmbajtja e-pasurisë çdo ditë 5. Sistemi për Menaxhimin dhe Arkivimin Elektronik të Dokumenteve çdo ditë			

Tab.5. Mirëmbajtja e infrastrukturës

Zyrtari për pranimin e mallit, gjatë periudhës Janar-Qershor të 2019, ka punuar në harmoni me përshkrimin e vendit të punës, ku ka realizuar objektivat që parashihen me planin e punës gjatë kësaj periudhe.

Pranues i mallrave ka kryer këto detyra të punës:

Pranimin dhe regjistrimin e mallrave në sistemin e menaxhimit të Pasurive (E-Pasuria), ku në të përfshihen materialet shpenzuese si dhe asetet Komunale, ku vlera e këtyre materialeve është 22,984.50€ apo mbi 54 lëndë. Janë bërë mbi 50 kërkesa për furnizime me material për zyre dhe inventar.

Janë bërë furnizime me material shpenzues si dhe inventar për të gjithë njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë duke përfshirë zyrën e Kryetarit dhe të gjitha drejtorit tjera dhe Komunitetet.

Ka asistuar në disa paramasa për furnizim me material shpenzues si dhe ka kryer detyra tjera që iu janë besuar nga menaxhmenti i Komunës.

Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim

I. Sektori i Financave

- Janë regjistruar 914 kupona të shpenzimeve në SIMFK (sistemi i menaxhimit të financave të Kosovës) përmes transferit me procedurë të prokurimit dhe aprovimit në vlerë prej 2,309,140.04 euro.
- Janë certifikuar 914 pagesa përmes transferit me procedurë të prokurimit dhe aprovimit në vlerë prej 1,309,140.04 euro.
- Gjatë kësaj periudhe në programin e Administratës Komunale dhe Arsimit parauniversitar janë dorëzuar në MAP – divizioni i pagave (punëtorë të ri, largime dhe ndryshime), 296 ndryshimet nga QKMF-ja dhe 296 kopje të pranuar të cilat janë përfshirë në evidencën e përgjithshme.
- Është bërë barazimi i të hyrave vetanake në baza mujore në mes të hyrave të arkëtuara dhe të hyrave të paguara.
- Janë pranuar, evidentuar, protokolluar 790 faktura, kontrata, vendime dhe të njëjtat janë dorëzuar për zotim dhe vijim të procedurës të mëtejme deri te ekzekutimi.
- Janë pranuar 525 raporte nga drejtoritë që inkasojnë të hyra vetanake në vlerë nën 10 euro dhe janë bërë 140 deponime në bankë.

II. Sektori i buxhetit dhe thesari

Gjatë periudhës Janar-Qershor të vitit 2019 janë kryer këto punë:

- Regjistrimi i obligimeve të pa paguara për periudhën Janar - Dhjetor 2018;
- Përgatitja e pasqyrave financiare për periudhën Janar - Mars dhe Janar - Qershor 2019;
- Sistemimi i të gjithë punëtorëve në sistemin e pagave nëpër të gjitha programet sipas planifikimit të buxhetit vitit 2019;
- Janë përgatit të gjitha deklaratat e disponueshmërisë së mjeteve për pagesë të projekteve, duke u bazuar në planifikimin e buxhetit e vitit 2019;
- Dhënia e informacioneve për të gjithë udhëheqësit e programeve buxhetore mbi gjendjen e rrjedhjes së parasë së gatshme për tërë vitin 2019.
- Barazimi i regjistrave të pasurive mbi dhe nën 1000 euro, të regjistruara në frebalanc/E pasuria si dhe regjistrimi në regjistra intern;
- Janë bërë zotimet e mjeteve për të gjitha programet buxhetore dhe kategoritë ekonomike varësisht nga kërkesat e autorizuesve të buxheteve përkatëse;
- Përpilimi i raportit të shpenzimeve për MF për TM-1 2019 dhe TM-2 2019;
- Raportimi i obligimeve të pa kryera në MF në departamentin e thesarit për çdo muaj dhe është bërë përgatitja e pasqyrave financiare për TM-1, TM-2 të vitit 2019.
- Përgatitja e qarkores së parë interne komunale 2020/01 e datës 15.05.2020 për të zhvilluar procesin buxhetor komunal 2020-2022.
- Përgatitja e Kornizës Afatmesme të Buxhetit (KAB) komunal për vitin 2020-2023, të datës 15.06.2019;
- Konsultimi i vazhdueshëm me drejtorët e drejtorive rreth inicimit të shpenzimeve të ndryshme komunale.

II. Sektori i Tatimit në Pronë

- Afrimi i shërbimeve për qytetarët e komunës për kryerjen e obligimit të tatimit në pronë;
- Afrimi i shërbimeve për qytetarët e komunës për pagesën e taksës komunale për automjete;
- Lidhja e marrëveshjeve me tatimpagues për pagesën e detyrimit tatimor sipas kushteve të parapara nga DFEZH dhe dhënia e këshillimeve palëve për kushtet e pagimit të tatimit në pronë;
- Gjatë periudhës Janar - Qershor të vitit 2019 janë shërbyer 7666 palë me vërtetime (struktura: 5172 vërtetime për regjistrim të automjeteve, 487 vërtetime për raste sociale dhe 2007 vërtetime për nevoja të katastrofit);
- Është kryer shpërndarja e mbi 11327 fakturave për çdo qytetar në Komunën e Vitisë;
- Gjatë periudhës Janar - Qershor të vitit 2019 janë inkasuar 204,457.78 euro nga tatimi në pronë dhe 43,040.00 euro nga taksa komunale për automjete;
- Realizimi i planit për tatimin në pronë shprehur në përqindje është realizuar 102.23 %, kurse taksa komunale për automjete është realizuar 108.28 %;
- Kemi përgatitur një plan të veprimit nga një komision kompetent për rritjen e shkallës së inkasimit të tatimit në pronë;
- Është përpiluar lista e borxheve të qytetarëve sipas fshatrave dhe paraqitja e përqindjes së realizimit të obligimeve për çdo lokalitet.

IV. Sektori për ekonomi dhe zhvillim

- Kemi bërë dorëzimin e raportit të punës për vitin 2019 dhe planin e punës për vitin 2019;
- Kemi bërë shqyrtimin e kërkesave të qytetareve për marrjen e pëlqimeve për shfrytëzimin e parcelave të Agjensionit pyjorë dhe të pronave nën menaxhimin e AKP-se;

- Kemi bere kërkesat pranë Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit për marrjen e lejeve te kërkuara nga Zyra e Projekteve;
- Me kërkesë të MTI-së, përkatësisht Divizioni I Turizmit, ne bëmë grumbullimin e informative gjegjësisht bëmë identifikimin e produktit turistik për rajonin e Anamoraves, Komuna e Vitisë.

V. Projektet e investimeve kapitale për vitin 2019 të financuara nga buxheti i Komunës së Vitisë dhe buxheti i nivelit qendror.

1	Participimi i projekteve me donator	298,123.83
2	Revitalizimi i ujësllësve	90,000.00
3	Asfaltimi i rrugëve rurale	407,176.67
4	Asfaltimi i rrugës Skifteraj - Stubëll e Poshtme	95,000.00
5	Rregullimi i kanalizimeve dhe gropave septike	295,203.13
6	Rregullimi i rrugëve me zhavor	191,777.34
7	Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit publik	330,000.00
8	Rregullimi i hapësirave gjelbëruese - publike	45,000.00
9	Rregullimi i fushave sportive	83,245.00
10	Rregullimi i lumenjve dhe prockave	70,000.00
11	Ndërtimi i urës në Binçë dhe zgjerimi i urës së Kurteshit- Pozheran	35,000.00
12	Rregullimi i rrethojave shkollore	15,000.00
13	Riparime nëpër shkolla	95,000.00
14	Renovimi i ambulantave	99,657.00
15	Furnizim me aparatura dhe digjitalizim	35,753.00
16	Asfaltimi i rrugës Goshicë-Gërmovë	55,705.00
17	Asfaltimi i rrugës Mogillë- Skifteraj	62,638.00
18	Asfaltimi i rrugës Sodovinë e Jerlive- Dardani	350,000.00
19	Rehabilitimi i rrugës Viti- Letnicë	250,435.00
20	Ndërtimi i urës mbi lumin Morava - Viti	49,904.00
21	Zgjerimi i rrugës nga Drobeshi deri te rruga e Mogillës- Viti	100,000.00

22	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Anton Ceta-sejdiu -Stubëll e Epërme	200,000.00
23	Ndërtimi i rrugës Viti -Kerbliq -Kaqanik	50,000.00
24	Renovimi i qendres rinore në Viti	25,000.00
25	Palestra sportive - Viti	100,000.00
26	Stadiumit i qytetit - Viti	151,305.04
27	Mulliri dhe velanica e Vishëve në Vërban	10,000.00
28	Ndërtimi i shkollës fillore në Pozheran	280,000.00
29	Zërimi dhe pajisjet të IT	40,000.00
30	Revitalizimi i ndërtesës së Komunës së Vitis	105,802.00
31	Renovimi dhe nderimi i infrastrukturës mbrojtëse të lumit "Morava"- Viti	400,000.00
32	Rregullimi i Varrezave të Dëshmorëve ne Viti UCK, derdhja ne bronz e busteve Gursel e Bajram Sylejmanit	50,000.00
33	Ndërtimi i shkollës së mesme të ulët "Dëshmorët e Vitisë" në fshatin Drobesh	250,000.00
34	Renovimi i shkollës fillore në fshatin Stubëll	70,000.00
35	Fusha ndihmëse e futbollit në fshatin Sodovine e Jerlive	250,000.00
GJITHËSEJT		5,036,725.01
36	Ndërtimi i zonave ekonomike -Parku industrial (për të gjitha zonat ekonomike në Kosovë)	2,500,000.00

Tab.6. Projektet e investimeve kapitale për vitin 2019

Projektet investive të financuara nga Donatore te jashtëm (bashkëfinancim me Komunën e Vitisë)

1. Ujës. në fshatin Smirë dhe Vërban (proj. dyvjeçar – CDI)..... 513,000.00 €
 2. Ujes. ne fshatin Stubell (proc. ekzek- dyvjeçar – CDI) : 281,408.00 €
 3. Nd. i gypit te ujit Viti-Letnic (proj. dyvjeçar CDI)328,938.00 €
 4. Ndihmë për bizneset fillestare – Kosova Luksemburg 76,669.36 €
 5. Programi për të drejtat pronësore (proj. trevjeçar USAID)200,000.00 €
 6. Pr. zhvillimi i bujqësisë ne Komunën e Vitisë (IKC).....19,800.00 €
 7. Projekti i BE.Cross-Border (2018-219) 116,493.50 €
 8. Renovimi i shtëpisë se kulturës (BE) (2018-2019)..... 182,000.00 €
 9. Rregullimi i ures te Germi (Demos)..... 37,530.30 €
 10. Renovimi i çerdhes "Gëzimi Ynë" (Demos) 54,300.43 €
 11. Projekti i UNDP për gjenerim dhe formalizim te punësimit..... 30,000.00
- Gjithsej 1,840,138.00 €

Realizimi i këtyre projekteve gjatë vitit 2019 do të ndikoj drejtpërdrejtë në përmirësimin e jetës të qytetarëve.

VI. Zyra për regjistrimin e bizneseve

- Gjatë periudhës janar-qershor 2019 janë regjistru 89 biznese të reja
- Gjatë kësaj periudhe janë shuar 11 biznese.
- Numri i përgjithshëm i të punësuarve është 134 punëtorë .

Drejtoria për Inspeksion

Drejtoria për Inspeksion vepron sipas organogramit të Drejtorisë Komunale të Inspeksionit dhe atë: Inspektori i Tregut, Ambientit, Sanitarisë, Komunikacionit, Bujqësisë, Veterinarisë, Pronës, dhe Ndërtimtarisë. Detyrat e drejtorisë janë implementimi i të gjitha vendimeve të Kuvendit Komunal, që kanë të bëjnë me punën e inspektorëve në terren dhe të gjitha Ligjeve përkatëse në fuqi të Kuvendit të Kosovës sipas specifikave të lëmive të inspektorëve.

Inspektorët e tregtisë

- 22 Procesverbale mbi legalizimin e veprimtarisë së subjekteve të biznesit dhe pajisje me leje pune dhe mbikëqyrjet tjera në aspektin e zbatimit të ligjit 2004 për legalizim të veprimtarisë si dhe pajisje me pranim teknik të lokaleve, si dhe bizneset që kanë ndërru selinë e veprimtarisë apo kanë zgjeruar hapësirat afariste, janë detyruar që të harmonizojnë veprimet e tyre në pajtim me ligjet në fuqi;
- 1 Kontrollë të përbashkëta me Policinë e Kosovës, njësia E KRIMEVE ekonomike dhe trafikim të qenieve njerëzore, në motele, bujtina dhe veprimtari të ngjashme hotelere;
- 10 Kontrollë mbi kualitetin, cilësinë, sigurinë e produkteve në qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve, së bashku me Inspektorët sanitarë, të veterinarisë, ku janë asgjësuar sasi e konsiderueshme e mallit të rrezikshëm për jetën dhe shëndetin e konsumatorëve;
- 1 Përpilimi i një drafte rregullore për orar pune të bizneseve në Komunën e Vitisë;
- 10 kontrolle në dyqane dhe supermarkete, mbi vendosjen e flamurit, zona artikujve ushqimorë;
- Nga kontrollet e ushtruara më lart, janë urdhëruar bizneset që të shpallim edhe njoftimet për ndalim shitjen, shërbim dhe dhurimit e duhanit dhe pijeve alkoolike personave nën moshën 18 vjeçare;
- 24 Kërkesa mbi pranimin teknik të lokalit në shume prej 2334.50 €;
- 20 Pranime teknike të lokaleve;
- 1 Kërkesë ku pronari në parashtrim të kërkesës i njëjti ka ndërpre veprimtarinë;
- 3 Kërkesa nga palët nga aspekti i procedurave nga veprimtaria e tyre;
- 20 proqesverbale të komisionit për pranim teknik;
- 30 Vizita tjera në biznese në aspektin e zbatimit të dispozitave të ligjit Nr:03/L-181 dhe dispozitave tjera mbi peshën dhe njësitë matëse, çmimet e artikujve, shpallja e emërimit të biznesit, kushtet e ushtrimit të veprimtarisë, e sidomos pajisje me leje pranim teknik të lokalit ku është kontribue shumë në Drejtorinë e Financave që të inkasojnë mjete financiare;
- 1 Takime pune me kryeinspektorin e inspektoratit të tregut në Prishtinë.

Inspektori i veterinarisë

Marrja e mostrave të gjakut për sëmundje infektive: mbi 20 mostra të marrura, prej tyre pesë kanë (bletëve), kanë rezultuar pozitiv në pestë amerikane;

- Kemi eliminuar kafshë me sëmundje infektive (tuberkulozë) 1 krerë, të groposura në varrezat e kafshëve me inspektoret e A.U.V-së dhe është duke u vazhduar në shëndetësimin e fermave;
- Inspektimi i vazhdueshëm i thertores në Pozhoran;
- Inspektime dyqaneve dhe maketeve, inspektimi i ushqimeve me prejardhje shtazore;
- Marrje të mostrave në mishtore në Pozhoran dhe Viti;

- Gjitha kërkesat e fermerëve janë shqyrtuar, qofshin ato gojore apo me shkrim;
- Inspektimi i Veterinerëve gjatë aplikimit të vaksinimit kundër sëmundjes gungore;
- Gjitha ngordhjet e kafshëve në teren që fermerët i kanë hudh, që ne nuk kemi pas mundësi identifikim janë gropos 5 krerë;
- Inspektim tregut të kafshëve dhe tregut të gjelbër;
- Takime me qytetarë në zyrë për probleme të ndryshme që i shqetësojnë qytetarët, dhe punë të tjera që kontribuojnë drejtorisë.

Inspektori i pronës

Në kudër të plan-programit të paraparë dhe autorizimeve që ka sektori i pronësisë brnda ketij gjashtë muor kemi zhvilluara këto aktivitete:

- Sipas detyrës zyrtare në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së pronës publike dhe Komunale kemi përfaqësuar organin në Gjykatën Themelore në Gjilan dega në Viti , në **11** raste të uzurpimit të pronës publike;
- Me Aktvendim kemi vendosur **7** raste në lidhje me konstatimin e uzurpimit të tokës në pronësi shoqërore;
- Në këtë periudhë kemi ushtruar **7** fletëparaqitje apo kallxime penale kundër uzurpatorëve arbitrar në Prokurorin Themelore në Gjilan;
- Kemi nxjerrë **5** konkluzione mbi lejimin e ekzekutimit;
- **6** lëndë janë ekzekutuar me vetiniciativë,nën presionin e kërcënimit të dhunshëm.

Të gjitha këto veprime i kemi koordinuar në bashkëpunim edhe me organet e gjeodezisë, si dhe angazhimin permanent i gjeodezisë, i cili për të gjitha rastet ka hartuar edhe kopjet e planit, si dhe identifikimin e kufijve rruge në tërë territorin e komunës së Vitisë.

Inspektori i mbrojtjes mjedisit

- Kemi inspektuar rrjetet e kanalizimit kolektiv të ujërave të zeza, ku një pjesë e tyre nuk përfundojnë në gropa septike dhe nuk kanë mbikëqyrje nga kompanitë kompetente;
- Në disa fshatra kemi shpërndarë njoftime publike lidhur me ruajtjen e mjedisit dhe pasojat ligjore për ndotësit e mjedisit;
- Kemi marrë pjesë në aksionin e pastrimit të mjedisit me 22 Prill „Dita e Tokës” dhe 5 Qershorin „Dita e Mjedisit” si dhe aksionin tremujor për pastrimin e mjedisit nga mbeturinat me moton „Ta Pastrojmë Kosovën”;
- Kemi marrë iniciativë për funksionalizimin e deponive të mbeturinave të ngurta (ndërtimore) dhe janë caktuar tri pika: Binçë, Radivojc dhe pika mes të fshatit Sllatinë e Epërme –Tërstenik;
- Kemi marrë pjesë në Gjykatë për shqyrtimin e lëndëve;
- Në këtë periudhë kemi ndërprerë 15 aktivitete ndotëse;
- Largimi i plehërave të kafshëve 4 raste;
- Ndalimi i rrjedhjes të ujërave të zeza në ambient të hapur 3.

Konstatim: Gjendja mjedisore në territorin e komunës nuk është e kënaqshme, sidomos (mbeturinave dhe ujërave të zeza), në lokalitetet ku mungon menaxhimi i mbeturinave përmes kompanisë dhe rrjeta e kanalizimit kolektiv. Mungojnë gropat septike të kanalizimit kolektiv. Edhe pse disa fshatra kanë shpreh interesim për menaxhimin e mbeturinave komunale përmes kompanisë, nuk ju kanë ofruar shërbim.

Inspektori i komunikacionit

- Kemi menaxhuar furnizimin dhe vendosjen e shenjave të Komunikacionit sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës në tërë territorin e komunës së Vitisë;

- Kemi hartuar 11 procesverbale sipas detyrës zyrtare;
- Kemi lëshuar gjithsejtë 8 (tetë) LEJE për vendosjen e pengesave 2 në Podgorc, 1 në Binçë, 1 në Rr.” Mustafë Koka “ në Viti, Tërpezë, Kabash etj;
- Kemi hartuar 48 Procesverbale mbi shikimin e Automjetit për transport publik –Taxi;
- Kemi bërë 50 Fletëpagesa për taksa komunale dhe atë 48 mbi shikimin e automjetit në vlerë prej 10 €, dhe 2 për Pëlqim mbi kyçjen në rrugë;
- Kemi bërë pranimin teknik të lokaleve së bashku me Ins. E Tregtisë dhe atë Sanitarë;

Pastaj kemi qenë edhe nëpër komisione të ndryshme si hapje të ofertave, vlerësime si dhe të pranimin të punimeve me vendime nga kryetari, si kanalizime, rrjete të ujësjellësit rrugë trotuare etj.

Inspektorët e ndërtimit

Në bazë të planit dhe programit të punës për këtë periudhë kemi zhvilluar këto aktivitete:

- Me këtë rast kemi hartuar **48 (dyzet e tetë)** procesverbale lidhur me fillin e punimeve të pa pajisura me dokumente për ndërtim;
- Gjithashtu kemi hartuar **33 (tridhjetë e tre)** vendime për ndërprerjen e punimeve;
- Kemi përgatitur dhe proceduar për Gjykatë këto lëndë:
- Për Kundërvajtje, **15**
- Për Vepër penale, **6**
- Lëndë në procedurë, **10**
- Lëndë të përfaqësuara në Gjykatën Komunale, **13**
- Kemi realizuar gjithsejtë **158** vizita në teren.
- Kemi asistuar të gjithë inspektorët e tjerë në aktivitetet e tyre dhe kemi pritur e shërbyer palë të ndryshme.

Inspektori i sanitarisë

Nr.	INSPEKTIME		Shprehur ne numra
1	Inspektime te objekteve afariste		81
2	Pranime teknike te lokaleve		21
4	Procesverbale		94
5	D-D-D		14
6	Inspektime te ujerave te pijshëm		10
7	Inspektime te ujarëve te zeza		2
8	Mostra te ujerave rurale		10
9	Mostra te ushqimeve		8
10	Pëlqime Sanitare		8
11	Aktvendime		10
12	Kundërvajtje		3
13	Vepra Penale		0
14	Libreza Sanitare		65

15	Inspektime te tregut		6
16	Asgjësim te artikujve ushqimor		26 tonë
18	Urdhëresa		10
19	Inspektime te objekteve shkollore		8
20	Inspektime te objekteve shëndetësore		6
21	Inspektime te pishinave		2
22	Exhumime		2

Tab.7. Inspektime

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë

Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2019 kemi pranuar gjithsej 105 kërkesa të natyrave të ndryshme, të cilat i kemi kryer në afatin ligjor.

Shpenzimi i buxhetit për periudhën Janar- Qershor, për komunal është 76,189.98 €, në përqindje 62 %, mallra dhe shërbime 179,298.20 € në përqindje 43%.

Realizimi i të hyrave vetanake për gjashtë muaj kapë shumën prej 16,672.75 €.

- Janë mirëmbajtur të gjitha rrjetet e ujësjellësit dhe kanalizimeve në tërë territorin e Komunës së Vitisë;
- Janë mirëmbajtur të gjitha rrugët lokale në tërë territorin e Komunës së Vitisë gjatë sezonit të dimrit dhe tani verës.
- Janë mirëmbajtur hapësirat e hapura publike;
- Është mirëmbajtur Ndriçimi publik në tërë territorin e Komunës së Vitisë;
- Është bërë pastrimi i Objekteve Komunale, Shëndetësore dhe Arsimore;
- Menaxhimi i mbeturinave është bërë nga sh.p.k. "Eco-higjiena";
- Eliminimi i deponive ilegale: janë eliminuar mbi 22 deponi ilegale dhe janë raportuar në platformën Ndreqe.com, si dhe me kërkesë të OSB-së është eliminuar një deponi ilegale në fshatin Pozharan nga pronari e një pronari serb, i cili ka shpreh dëshirë të kthehet në pronën e vet.

Sektori i Emergjencave

- Puna në vazhdimësi në hartimin e Planit për Reagim Emergjent Komunal;
- Takimi i mbajtur me 25 prill 2019 me një pjesëmarrje të gjerë në lidhje me shkresën e kryeministrit për parandalimin e zjarreve malore;
- Dëmtimet nga zjarri në periudhën nga muaji shkurt deri prill kanë përfshirë një sipërfaqe prej 60 hektar pyje, si:
 - Në fshatin Podgorcë me datë 18.03.2019, me një sipërfaqe prej 0.8 hektarë të djegur;
 - Në fshatin Buzovikë me datë 22, 23.03.2019, me një sipërfaqe prej 2 hektarë të djegur;
 - Në pyjet e zhegovcit të Jugut me datë 25-30.03.2019, me një sipërfaqe prej 35 hektarë të djegur;
 - Në pyjet e kopilaqës me datë 5,6,7 .04.2019, me një sipërfaqe prej 10 hektarë të djegur etj.

Njësi NJPZSH ka pasur 209 dalje , nga të cilat:

- Zjarre, 179
- Intervenime teknike, 7
- Shërbime, 20
- Aksidete rrugore, 3

- Vërshime, 5
- Të rrejshme, 1.
- Janë atestuar të gjitha aparatet e zjarrfikjes në objektet e Administratës Komunale, Shëndetësisë dhe objektet arsimore.

Sektori i Shërbimeve Publike

- Kemi lëshuar vendime dhe ngarkesa për shfrytëzimin e hapësirave publike për vitin 2019, si dhe janë bërë pagesat për shfrytëzimin e hapësirave publike, vendosjen e reklamave etj;
- Kemi përcjell edhe punët e kompanisë për mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve, si: pastrimi i rrugëve lokale nga akulli dhe bora, bartjen e disa kafshëve të ngordhura dhe varrosjen e tyre, mbushjen e gropave me kubza betoni nëpër rrugë të asfaltuara, furnizimin me zhavor nëpër rrugët e rendit të katërt mbushja gropave me asfalt nëpër rrugë të asfaltuara;
- Vazhdimi i lejeve të punës për Auto Taxi dhe ndërrimi i të dhënave;
- Lejimi i lejeve të punës për Auto Taxi;
- Leje për parkim të rezervuar;
- Përgatitja e propozim vendimeve për DSHPE-në;
- Leje të transportit të veçantë publik në Komunën e Vitisë;
- Leje të transporti të veçantë dhe leje tjera;
- Përgjigje, kërkesa, njoftime, cedim të kërkesave, raporte, vërtetime, padi;
- Kontrata për shërbime të veçanta;
- Pjesëmarrja në komisione të ndryshme në zyrën e prokurimit etj.

Sektori i trafikut dhe transportit publik të udhëtarëve organizohet përmes kompanive private të transportit dhe taksistëve individual si transport urban. Kompanitë e transportit publik urban - periferik janë tetë (8), ndërsa kompanitë e transportit ndër-urban janë tri (3).

Inspektori i parandalimit të zjarreve

- Inspektime të përgjithshme të rregullta dhe verifikuese 30;
- Inspektim në sektorin privat 25;
- Inspektim në sektorin shoqëror 5;
- Janë shqiptu 185 vërejtje;
- Numri I vërejtjeve 94;
- Numri I propozimit të masave 94;
- Shikime në vendngjarje të zjarreve 15;
- Raporte zjarre për njësit hetuese të policisë 13
- Kërkesa nga palët 1.

Punët me Skipin e Komunës

- Hapja e kanaleve të ndryshme;
- Largimin e borës nga rruga;
- Largimin e mbeturinave;
- Varrosjen e kafshëve të ngordhura;
- Mbyllja e rrugëve malore;
- Rregullimi i hapësirave publike;

- Rregullimi i rrugëve nga gërryerjet erozive. Pra, me skipin e komunës janë kryer pune të ndryshme dhe atë në total 228 orë pune;
- Vazhdimi i punimeve në ndërtimi i objektit të Zjarrëfiksave;
- Realizimi i projektit me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ndërmarrjen sh.p.k. Ecohigjiena dhe Komuna e Vitisë, "Punë Publike në Komunën e Vitisë", në të cilin projekt janë punësuar 20 punëtor për një periudhë kohore prej gjashtë muajsh, në pastrim të ambientit.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

I. ZYRA E DREJTORIT TË DSHMS-SË

Zyra e Drejtorit të DSHMS-së përbehet nga drejtori, juristi dhe punëtori i administratës. Punët të cilat janë kryer nga stafi drejtpërdrejtë i drejtorit janë paraqitur në tabelën si në vijim me të dhënat konkrete të punëve, si ndarja e subvencioneve për ndihmë momentale të cilat janë aprovuar nga komisioni në përbërje të tre anëtarëve pastaj edhe ato të cilat janë pranuar, të proceduara dhe të aprovuara, si dhe ato që janë refuzuar dhe janë nën pezullim. Lëndët të cilat janë shqyrtuar nga kjo zyrë për këtë gjashtëmujor i gjeni në tabelën e mëposhtme:

• PËRCJELLJA E POLITIKAVE NË SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Vizitat e shpeshta dhe kontaktimi me punëtorë si dhe me stafin udhëheqës të njësive punuese QKMF DHE QPS, të cilat janë bërë me qëllim të bashkëpunimit dhe të identifikimit të problemeve për një menaxhim sa më efikas. Vizitat e tilla të koordinuara kanë dhënë rezultate të dukshme në afrimin dhe komunikimin ndër-institucional në mes këtyre dy njësive punuese.

• TAKIMI I STAFIT PËR PROMOVIM TË PUNËS EKIPORE.

Takimet të shpeshta brenda javës janë mbajtur në secilën njësi punuese me ekipin udhëheqës me qëllim të hartimit të strategjive për punë ekipore dhe vendosjen e një plani të detajuar.

Projekte kapitale

- Rregullimi i ambientit të jashtëm (oborrit) të AMF-së në Skifteraj;
- Përfundimi i procedurave të tenderimit për renovimin e QKMF-së dhe disa AMF-ve dhe punimet do të vazhdojnë edhe në gjashtë mujorin e dytë;
- Përfundimi i procedurave të tenderimit për furnizim me aparatura medicinale, përderisa furnizimi do të bëhet në pjesën e dytë të vitit;
- Uniformimi i stafit shëndetësor me uniforma të reja të standardeve më të larta dhe kualitative.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

- Vazhdimësi bashkëpunimi mbi Asgjësimin e mbetjeve medicinale në marrëveshje me Spitalin Regjional të Gjilanit;
- Marrëveshje me Instituti Regjional të Shëndetësisë Publike në Gjilan për kontrollimin e ujit të pijshëm nëpër vendet rurale si dhe në objektet institucionale dhe ato për qytetarë në vende publike;
- Vazhdon kontrata dypalëshe në mes të komunës së Vitisë dhe KARITAS Kosova për ofrim të shërbimeve mjekësore nëpër familje ku paraqitet nevoja për ndihmë mjekësore;

DONACIONET

- Furnizimi me 8 shtretër dhe 30 ormanë, donacion i dhënë për QKMF-në nga bashkatdhetarët tanë nga Zvicra;
- Një karrige stomatologjike dhe një mikroskop me ekran nga Ministria e Shëndetësisë;
- 47 kompjuterë dhe katër printerë nga Ministria e Shëndetësisë për digjitalizimin e SISH-it (Sistemi Informativ Shëndetësor);

- 500 kuti tableta Prenatal për shtatzëna;
- Shpërndarja e pakove ushqimore për 40 familje në nevojë donacion nga KARITAS Kosova;
- Shpërndarja e pakove ushqimore për 220 familje donacion nga "Qatar Charity";
- Shpërndarja e pakove ushqimore për 55 familje nga shoqata "Jetimat e Ballkanit".

PROMOVIMI I SHËNDETIT

- Më 21 mars është shënuar dita botërore për personat e prekur me sindromen Daun, me moton "*Më përkrash sot që nesër të jem i pavarur*";
- Më 8 prill, është shënuar dita botërore e shëndetësisë me ç'rast në qendër të qytetit është bërë shpërndarja e fletushkave informative në lidhje me shërbimet shëndetësore që ofrohen në QKMF, si dhe të drejtat e pacientit;
- Më 23 prill shënohet java e vaksinimit ku dhe i është bërë vizitë komunitetit RAI në Pozheran;
- Më 7 maj, kanë filluar vizita sistematike në Shkollat e Fillore të Komunës së Vitisë në klasat e pesta dhe janë kryer 654 ekzaminime të nxënësve të cilat përfunduan më 29 maj;
- Më 10 maj në Viti, u shënuar Java e Infermierisë me ligjëratën mbi rolin e infermierisë në sigurimin e shëndetit me stafin shëndetësor në përgjithësi;
- Më 17 maj, u shënuar dita botërore e hipertensionit me ç'rast ekipi mjekësor ka vizituar shoqatën e pensionistëve në Viti ku ka bërë matjen e tensionit arterial, sheqerit si dhe shpërndarjen e fletushkave të vetëdijesimit në qytetin e Vitisë;
- Më 27 maj, shënohet dita e mjekësisë emergjente;
- Më 31 maj në ditën botërore "Pa duhan", me moton "*Vrasësi i heshtur i të rinjve-Duhani*", janë organizuar ligjërata në bashkëpunim me shkollat e mesme në shtëpinë e Kulturës dhe marshin e përbashkët në qytet;
- Më 14 qershor Shënohet dita botërore e dhurimit të gjakut me moton "*Çdo dhurues gjaku është një hero*" ku 41 persona iu përgjigjën kësaj thirrjeje për të dhuruar gjak.

II QKMF –VITI ME NJËSITË E SAJA NË TERRITORIN E KOMUNËS SË VITISË

Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare bëhet ofrimi i shërbimeve mjekësore për qytetarë sipas këtyre kategorive mjekësore:

1. Shërbimet primare:

- a. Mjekësia familjare,
- b. Stomatologjia,
- c. Imunizimi,
- d. Emergjencia.
- e. Diagnostika (Laboratori dhe Shërbimi Radiologjik).

2. Shërbimet specialistike

- a. Pediatria,
 - b. Shërbimi i sëmundjeve të brendshme (internisti).
- Gjithsesi, në QKMF në qytetin e Vitisë punohet 24. Të gjitha shërbimet mjekësore familjare, stomatologjike, pediatrie, interne, laboratorike si dhe radiologjike kryhen vetëm gjatë ndërrimit të parë të orarit të punës.
 - Qendra e emergjencës punon gjatë 24 orëve për çdo ditë të javës.
 - Gjatë këtij gjashtëmujori, puna në QKMF duke e krahasuar me të kaluarën, mund të vërehen ndryshime të theksuara si në respektimin e orarit të punës si dhe në cilësinë e shërbimeve të ofruara mjekësore.

QMF-TË SI DHE AMF-TË TË CILAT KANË FUNKSIONUAR GJATË KËSAJ PERIUDHE NË KOMUNËN E VITISË

1. QMF-Pozheran

2. QMF-Sllatinë e Epërme
3. QMF-Smirë
4. QMF- Sodovinë
5. AMF-Beguncë
6. AMF-Skifteraj
8. AMF-Stubëll
9. AMF-Tërpezë

GJENDJA NË TERREN

1. Në Qendrën Mjekësore familjare në Pozheran punohet 24 orë pa ndërprerë. Në kuadër të kësaj qendre ofrohen të gjitha shërbimet e mjekësisë familjare, si dhe shërbime stomatologjike, por edhe kryhen analizat e ndryshme laboratorike gjatë ndërrimit të parë.
2. Qendra e Mjekësisë Familjare në Sllatinë të Epërme ofron shërbimet infermierie gjatë gjithë javës në orar të rregullt.
3. Në QMF në fshatin Smirë punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, me shërbime infermierie.
5. QMF në Sodovinë ka qenë e mbyllur këtë gjashtëmujor si shkak i renovimit (fillon me punë më 1 korrik 2019).
6. Në AMF-në e Skifterajt punohet dhe ofrohen shërbime çdo ditë punë nga ana e infermierëve, përveç vikendit, ndërsa shërbimet e mjekut mund t'i marrin në një ditë pune.
7. Në AMF në e fshatit Beguncë ofrohen shërbime infermiere çdo ditë pune përveç vikendit.
8. Në fshatin Tërpezë shërbimet mjekësore ofrohen çdo ditë pune nga infermieret.

Shërbimet e ofruara nga QKMF-ja –QMF-ja dhe AMF-të

Shërbimet të cilat u janë ofruar qytetarëve në QKMF, QMF dhe AMF-të për këtë gjashtë mujor janë dhënë gjithsejtë **263,768.00** shërbime. Për më tepër, të gjitha llojet e shërbimeve janë të paraqitura përmes tabelës që i bashkëngjitet këtij raporti. (Shih tabelën) Mjetet e grumbulluara nga participimi për shërbime shëndetësore janë **28,299.20** Gjithashtu për çdo muaj veç e veç mundë të shihet në tabelën e bashkëngjitur.(Shih tabelën).Të hyra nga qiraja për këtë gjashtëmujor janë **5,040.00** €.

Llojet e shërbimeve shëndetësore në QKMF, QMF dhe Amf-të

RAPORTE	Vizita	Therrje	Transfere	Transferd iagnostike	Lidhje	Inhalime	Këshilla	Ekg	Nr. Analizave	Nr.nxjerr ieve	Liruar nga
Emergjenca	28602	2252 5	2478		777			729			2263 0
Mjekësia familjare 1	10921	5821	1878								1227 3
Mjekësia familjare 2dhe 3	10122		2120								5418
Stomatologjia	1393									520	1305
Rtg	936										490
Ekipi i terrenit	600	477			39						639
Dhoma e infuzioneve		1899									1450

Laboratori	5679								6351 6			4529
Pediatria	1872		17	30			97					1872
Interno	452							240				365
Kontrolle gjinekologjike		127					69					191
Shërbimi i vaksinimit	1450	6024										1450
Inhalime në QKMF						281						281
Lidhorja					108 7							1056
Ambulanta Smirë		77			85		285					449
Amb.Sllatinë		228			101	3	56					379
Amb.Pozheran	21968	1546 6	2585		972	37	63	36				1605 9
Lab.Pozheran	1982								1936 2			1581
Stom.Pozheran	96									53		89
Amb. Terpeze		119			75		118					301
Amb.Skifteraj	21	66			38		71					197
Amb.Bëguncë	4	59			85		106					250
Amb. Letnicë												
Amb.Stubëll	529	115			62	6	69					576
Amb.Remnik												
												8469 6
	86627	53003	9078	30	3321	327	934	1005	82878	573		

**GJITHSEJTË
SHËRBIME**

263768

Tab.8. Pasqyra e mjeteve të grumbulluara nga participimi

Nr.	Shërbimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qeshor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	gjithej
1	Emergjencia	1183.5	1419	1705.5	1593.5	1372	1121.5							8395
28 2	Arka 1	2055.7	2322.7	2280	1982.1	1783.6	1438.6							11862.7
3	Pozheran	1424	1468	1613	1245.5	1241.5	1049.5							8041.5
4	Gjylekarë													
5	Terpez													
6	Smire													

7	Sllatinë													
8	Remnik													
9	Beguncë													
10	Sadovin e Jerlive													
11	Goshicë													
12	Letnicë													
13	Stubell e E.													
14	Gjithsejt	4663.2	5209.7	5598.5	4821.1	4397.1	3609.6							28299.2

TAB.9. SHËRBIME

ZHVILLIMI DREJT NGRITJES SË CILËSISË SË KUJDESIT SHËNDETËSOR

- Menaxhmenti i QKMF-së në Viti është munduar të rrisë kualitetin e shërbimeve shëndetësore përmes trajnimeve të stafit mjekësor dhe infermierik, përmes seminareve dhe trajnimeve të ndryshme. Gjatë kësaj periudhe punëtorët shëndetësor kanë qenë pjesë e trajnimeve të organizuara në Viti, Gjilan dhe Prishtinë;
- Në bashkëpunim me organizatën Kosovo Management Institute është mbajtur trajnimi i 80 punëtorëve shëndetësor të QKMF-së në Gjilan për 10 javë me radhë;
- Janë mbajtur trajnime për Lidership me organizatën AQH në Prishtinë;
- Për 6 javë me radhë në bashkëpunim me UNDP, dhe Ministrinë e Shëndetësisë janë dërguar mjekë në trajnimin "Dhuna në baza Gjimore";
- Janë mbajtur trajnime shtesë në praktikumin e sistemit kompjuterik të SISH-it nga ana e kompanisë përkatëse ofruar për tërë stafin shëndetësor e që është mbajtur në QKMF-së;
- Aktivitet të edukimit të vazhdueshëm profesional (EVP), ku për gjashtëmuajorin e parë janë mbajtur dhjetë ligjërata nga stafi shëndetësor.

III RAPORT NGA QENDRA PËR PUNË SOCIALE-JANAR-QERSHOR 2019

Qendra për Punë Sociale (QPS) është organ publik i administratës e cila aktivitetin e vet punues e ushtron në kuadër të administratës Komunale në Viti, njësi e DSHMS-së, ofron shërbime për të gjithë qytetarët që gjenden në territorin e Komunës e që kanë nevojë për këto shërbime. Për periudhën kohore 01.01 deri më 30. 06. 2018, punët në kuadër të QPS -Viti janë të paraqitura në tabela.

RAPORT I SHËRBIMIT SOCIAL QPS - VITI, PËR GJASHTË MUJORIN E PARË-2019

Kategoritë e rasteve	Raste të reja	Përsëritëse	Te bartura nga vitet tjera	Gjithsejtë	Vendosja në institucione	Te reja	Te bartura
Raporte të çrregulluara bashkë-besim i fëmijëve	9	0	9	18			
Te mitur në konflikt me Ligjin	35	23	69	127			
Dhuna në familje	17	0	10	27			
Te mitur me sjellje asociale	7	3	12	22			
Fëmijët e keqtrajtuar fizikisht	11	0	9	20			

Kujdestari e fëmijëve	2	0	38	40			
Fëmijët ne Streh. familjar tek te afërmit	1	0	9	10			
Fëmijët e vendosur ne famil. strehuese	0	0	0	0			
Adoptimi i fëmijëve	2	0	2	4			
Kontaktimet prind-fëmije	3	0	20	23			
Keqtrajtimet-ngacmimet sex.te femij.	0	0	0	0			
Te moshuar pa përkujdesje familjare	2	0	3	5	4 SHPMPPF	1	3
Te rritur me nevoja te veçanta	0	0	4		ne Shtime,3 ne Ferizaj 1 dhe ne Kamenice 1	1	4
Fëmijët me nevoja te veçanta	4	0	46	50			
Ftesa gjyqësore për te mitur	34	0	0	34			
Ftesa gjyqësore për te rritur	5	0	0	5			
Lypës te rrugës	0	0	0	0			
Masat e shqiptuara për te mitur; M.SH.P	10	0	0	10			
M.O.K.	2	0	0	2			
Qortim	7	0	0	7			
Burg	2	0	0	2			
Vërtetime për nënshtetësi	39	0	0	39			
Vërtetime për zotësi veprimi-Arme	120	0	0	120			
Vërtetime për zotësi veprimi-Pune	43	0	0	43			

Raste tjera ne nevojë për shërbime	33	0	0	33			
Ankesa komis.mj.shk.II	2	0	0	2			
Fëmijët e vendosur ne institucionet mbrojtëse	0	0	1	1			
Vendosja stre-dhunë familjare	1	0	0	1			
Regjistr.i mëvonshëm i fëmijëve	1	0	0	1			
Përdorues te narkotikeve	5	0	0	5			
Martesa e parakohshme	2	0	0	2			
Urdhër mbrojtje për viktimat e dhunës ne familje	3	0	0	3			
Shërim i detyrueshëm psikiatrik	1	0	0	1			
Mase e shqiptuar me Gjoke	2	0	0	2			
Te kthyer nga zonat e luftës se huaj	2	0	0	2			

Tab.10. RAPORT I SHËRBIMIT SOCIAL QPS – VITI

SHERBIMI I ASISTENCES SOCIALE

PASQYRA E PAGESAVE TË ASISTENCËS SOCIALE PËR PERIUDHËN Janar-Qershor-2014		
<i>Muaji</i>	<i>Pagesa mujore</i>	<i>Gjithsej familje</i>
<i>Janar</i>	<i>52125.00 €</i>	<i>485</i>
<i>Shkurt</i>	<i>52577.50 €</i>	<i>486</i>
<i>Mars</i>	<i>53795.00 €</i>	<i>499</i>
<i>Prill</i>	<i>53635.00 €</i>	<i>490</i>
<i>Maj</i>	<i>52895.00 €</i>	<i>482</i>
<i>Qershor</i>	<i>50282.50 €</i>	<i>467</i>

Tab.11. SHERBIMI I ASISTENCES SOCIALE

Gjitha rastet e shqyrtuara për Asistencë Sociale

Rastet e shqyrtuara	Gjithsejtë	Aprovuar	Refuzuara
Aplikim për herën e parë	29	26	3 gjithsejtë
Ri-aplikim	396	394	2 /.
Gjithsejtë	430	423	7 /.

Tab.12. Rastet e shqyrtuara për Asistencë Sociale

Lëndët e shqyrtuar nga komisioni mjekësor

Të aprovuara	Të refuzuara - Në rishqyrtim	Gjithsejtë
185	8 21	214

Tab.13. Lëndët e shqyrtuar nga komisioni mjekësor

Lëndët e shqyrtuara sipas ankesës

Te trajtuara	Aprovuara	Refuzuara	Gjithsejtë
Në shkallë të parë	1	8	09
Në shkallë të dytë	0	1+1 në shqyrtim	02
Gjithsejtë	2	11	13

Tab.14. Lëndët e shqyrtuara sipas ankesës

Familjet e ndërprera për arsye të ndryshme ligjore

Gjithsejtë	43 familje
------------	------------

Tab.15. Familjet e ndërprera për arsye të ndryshme ligjore

Nga shërbimi janë dhënë gjithsejtë 170 vërtetime me taksa komunale.

Pa taksa komunale

Drejtoria për Arsim

I. Aktivitetet e Implementuara

- ❖ DKA-ja me kohë ka mbledhur shënimet për numrin e nxënësve të shkollave fillore të cilët duhet të pajisen me tekste mësimore për vitin e ri shkollor 2019/2020, të cilat do të shpërndahen sipas kërkesave të shkollave;
- ❖ Testi i Arritshmerisë u mbajt në muajin maj 2019;
- ❖ Testi i Maturës për afatin e Qershorit u krye me sukses. Me datë 13 Qershor është mbajt test i Maturës kalushmeria ka qen 65%.DKA-ja i ka kryer me kohë të gjitha përgatitjet dhe organizimet që bin në kompetencë të saj;
- ❖ Drejtorët e shkollave kanë dorëzuar raportet për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë;
- ❖ Janë planifikuar paralelet me nxënësit fillestar që do të regjistrohen në klasën e parë për vitin e ri shkollor;
- ❖ Po ashtu, arsimtarët e fushave të ndryshme, me qëllim të ngritjes së tyre profesionale, kanë marrë pjesë në trajnime, seminare, debate etj;
- ❖ Janë kryer përgatitjet dhe janë regjistruar nxënësit në klasën e dhjetë të shkollave të mesme;
- ❖ Janë mbajtur debate, konsulta për tema të ndryshme rreth dukurive negative të nxënësve nëpër shkolla;
- ❖ Është duke vazhduar trajnimi i mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës së re me mësuesit e klasave të para si dhe mësimdhënësit lëndorë;
- ❖ Aktivitet e shumta jashtë shkollore, si për ditën e ambientit dhe për ditët e tjera që kanë për qëllim promovimin e të drejtave të njeriut;

- ❖ Në bashkëpunim me QKMF është përfundu cikli i parë i kontrolleve shëndetësore të fëmijëve për klasat e 5-ta;
- ❖ Në bashkëpunim me Plus Tv, është zhvilluar Gara e Diturisë “Maratona e Dijës” për 17 Shkollat e Mesme të Ulëta;
- ❖ Janë mbajtur garat në fushën e mendimit kritik dhe në fushë e diturisë të organizuar nga koordinatori nacional për rini.

Shërbimi psikologjik

- ❖ Është bërë evidentimi i rasteve (nxënësve), të cilët kanë nevojë për shërbim psikologjik;
- ❖ Vazhdim i psikoedukimit me nxënës, duke përfshirë fusha të ndryshme;
- ❖ Administrimi i testeve psikologjike, duke përfshirë ata të inteligjencës, personalitetit, organicitetit etj. (HTP test, Mini School test, Unit test, Bender Gestalt test 1, Bender Gestalt 2, Kohchs test, Raven test, Vineland scale, EPI test, MMPI 201 test etj);
- ❖ Mbajtja e seancave psikoterapeutike. Nxënësit janë trajtuar me:
 - Këshillim psikologjik;
 - Teknika biheviorale;
 - Psikoterapi pozitive;
 - Psikoterapi trupore;
 - Psikoterapi familjare pozitive;
 - Punë e vazhdueshme tek klasa e bashkëngjitur me nxënësit me nevoja të veçanta;
 - Është vazhduar puna e Ekipes për vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta;
 - Mësimi i shkrim leximit dhe zbatimi i alfabetit Braille, për nxënësit e verbër dhe për ata me vështirësi në të pamurit.

Sektori i financave

- ❖ Brenda kësaj kohe kemi kryer obligimet nga viti 2018;
- ❖ Është duke u bërë furnizimi shkollave me lende djegëse (dru);
- ❖ Të gjitha shkollat me kohë janë duke u furnizuar me material higjienik, material harxhues, material pune për zyra etj;
- ❖ Po ashtu në këtë sektor janë bërë edhe ndryshimet në regjistrat e pagave si: futja e punëtorëve të rinj në listat e pagave, ndërrimet e llogarive bankare për punëtorët etj;
- ❖ Korrigjimi i përvojës për gjithë mësimdhënësit, stafin administrativ dhe teknik të shkollave;
- ❖ Jemi duke bërë përgatitjet për shpalljen e tenderit për furnizim me material zyrtar pedagogjik;
- ❖ Renovimi në shkollat e Komunës së Vitisë veç ka filluar në ato shkolla ku ka qen i nevojshëm intervenimi, në mënyrë që me fillimin e vitit të ri shkollor të jemi të gatshëm;
- ❖ Fillimi i Renovimi
 - objekteve shkollore: vendosja e rrethojave në oborret e shkollave, rregullimi i fushave sportive, rregullimi i oborreve dhe hapësirave gjelbëruese të shkollave;
- ❖ Kemi përgatitur kornizën afatmesme të shpenzimeve 2020-2022;
- ❖ Po ashtu shkollat sipas kërkesave të tyre janë duke u furnizuar me inventar shkollor dhe nevojat e tyre, si karrige, banka, tabela. Të gjitha furnizimet janë bërë në bazë të nevojave të paraqitura nga menaxhmenti i shkollës.

Sektori i administratës

- ❖ Në periudhën kohore janë protokolluar 275 lëndë të natyrave të ndryshme;
- ❖ Vendime të çështjeve të ndryshme, kontrata, konkurse, përgjigje në padi për gjykatën, njoftime, përgjigje në kërkesa, ankesa, vërtetime, pëlqime si dhe shkresa tjera;

- ❖ Për këtë periudhë kohore kemi shpallur 2 konkurse publike për punëtorë arsimor dhe janë pranuar gjithsej 19 punëtor arsimor;
- ❖ Me kohë kemi shpallur konkurset publike për kuadër arsimor për vendet e lira të punës dhe ndryshimet i kemi bërë me kohë në fillim të çdo muaji;
- ❖ Kemi bërë një planifikim të mirë, pasi që të gjithë punëtorët arsimor janë të pajisur me kontrata të punës dhe të gjithë të punësuarit në Sektorin e arsimit janë të futur në sistemin e pagave;
- ❖ Që nga muaji shkurt kemi filluar pagesën e tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit të mësimdhënësve, pasi që është siguruar buxheti nga Ministria e Financave për këtë kategori;
- ❖ Me rastin e rekrutimit (pranimit) të personelit arsimor, kemi zbatuar normativin në fuqi, duke filluar nga Ligji i Arsimit, Udhëzimin Administrativ të MPMS-së dhe aktet tjera nënligjore;
- ❖ Po ashtu kemi edhe konfirmimin nga Inspektorati Regjional i Punës për rregullaritetin e rekrutimit dhe pranimit të mësimdhënësve dhe të gjitha ankesat e palëve të pakënaqura janë refuzuar;
- ❖ Gjatë punës ky sektor gjithmonë ka parasysh parimin e efikasitetit në punë, me rastin e shqyrtimit të kërkesave, ankesave dhe veprimeve tjera procedurale, duke respektuar afatet ligjore dhe zyrtare.
- ❖ Jemi duke i bërë parapërgatitjet për shpalljen e konkursit të rregullt publik për mësimdhënës për vitin shkollor 2019/20, në planifikimin e pozitave të lira, duke kërkuar nga drejtorët e shkollave informata për pozitat e lira.

Bashkëpunimet

- ❖ Bashkëpunime me organizatat dhe donatorët;
- ❖ Vazhdimi i i projektit me Peace Corps Kosova (vullnetaret amerikan) në dy shkolla në Ramjan , Pozheran kete vit edhe SHFMU "Dëshmoret e Vitisë" Viti;
- ❖ Implementimi i projektit me USAID dhe Programin ASSET (rregullimi i qendrës së inovacionit dhe ndërmarrësisë) në Gjimnazin "Kuvendin i Lezhës";
- ❖ Në bashkëpunim me Fondacionin Kosovë Luksemburg, në Gëmovë janë pajisur kabinetet me mjete të konkretizimi, rregullim të bibliotekave dhe është hapur klasa e parashkolloreve;
- ❖ Implementimi i projektit nga Zyra Japoneze në Kosovë "Renovimi i Shkollës së Stubllës";
- ❖ Implementimi i projektit të Këshillit të Evropës dhe të projektit të shkollat e Shekullit 21 nga Shkolla "Hali Alidema".

Vështirësitë të cilat kanë qenë evidente gjatë vitit shkollor 2018

- ❖ Po ashtu edhe shkolla fillore në Pozheran është objekti vjetër dhe pa dyshim paraqet pengesë për zhvillimin normal të procesit mësimor;
- ❖ Kemi një rënie të numrit të nxënësve në zonat rurale ku na ka sjellë vështirësi, pasi ndarja e grandit specifike të buxhetit për arsim ndahet për nxënës, kemi pasur një zvogëlim të këtij grandit;
- ❖ Zvogëlimi i vazhdueshëm i numrit të nxënësve, si pasojë e rënies së natalitetit dhe migrimit po reflektohet në shuarjen e paraleleve dhe për pasojë po vë deri te reduktimi i vendeve të punës së mësimdhënësve. Mirëpo në vazhdimisht po kërkojmë zgjidhje duke planifikuar me kohë dhe duke bërë transferimin e mësimdhënësve nëpër shkolla;
- ❖ Greva e Përgjithshme në arsim ka qenë sfidë për këtë periudhë.

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit

Ky raport është i bazuar në kërkesat dhe detyrave të cilat jemi të obliguar që në harmoni me planet që janë të dale nga "Plani Zhvillimor Komunal" Nr.01-013/126, i datës 07.02.2011, "Plani Zhvillimor Urban" me Nr.01-

013/126, i datës 07.02.2011; Planet rregulluese “Zona Qendrore dhe Jugore dhe Lumi”, me Nr.01-013/1275, i datës 21.02.2013 si dhe “Zona Veriore” me Nr.01-013/869, i datës 08.10.2013;

Implementimin e kriterëve ndërtimore të dalë nga “Rregullorja për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të objekteve në Komunën e Vitisë” Nr. 01-013/317, të datës 15.03.2011;

Kontrollimi i planeve rregulluese detale të miratuara në raport me kërkesat për ndërtim nga qytetarët;

Kërkesa për dhënie të informatave për parcelat të ndryshme se çfarë destinimi kanë me plane zhvillimore komunale dhe urbane;

Gjatë gjashtëmujori të parë të vitit 2019, kjo drejtori ka kryer këto punë dhe aktivitete të përshkruara sipas planit të punës për vitin 2019. Kjo drejtori ka kryer këto punë dhe aktivitete të përshkruara sektor për sektor:

Sektori i Urbanizmi:

Gjithsej 19 kërkesa

❖ Kërkesa për pëlqime urbanistik.....	07
• Të shqyrtuara	07
• Të miratuara	07
• Të refuzuara	00
• Në proces	00
❖ Kërkesa për leje ndërtimore	12
• Të shqyrtuara	12
• Të miratuara	09
• Të refuzuara	03
• Në proces.....	00
❖ Shqyrtimi i kërkesave	100%
❖ Realizimi i planit vjetor i të hyrave mbi	53%

Sektori i Planifikimit

- Aktivitete në Përgatitjen e procesit të Hartimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK);
- Përfundimi i Bazës së të dhënave (DTB-së) në bashkëpunim me GIZ-in Gjerman;
- Janë funksionalizuar dhe kanë filluar puna në grupe të këshillave dhe grupeve punuese për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal(PZHK);
- Ka filluar bashkëpunimi me Institutin e Planifikimit Hapësinor të MMPH (janë mbajtur 4 takime pune);
- Është bërë grumbullimi i të dhënave sektoriale në të gjithë sektorët që shërbejnë për hartimin e PZHK-së dhe planeve tjera hapësinore.

Kërkesa	18
• Të shqyrtuara	18
• Në proces	00

Informata urbanistike.....	13
• Të shqyrtuara	13
• Në proces	00

Kushte të ndërtimit.....	05
• Të miratuara	02

• Të refuzuara	03
• Në proces.....	00

Sektori i Mjedisit

Punët e kryera në Sektorin e Mjedisit duke përfshirë edhe ato administrative janë të radhitura në formë të raportit:

- Është punuar projekti për muajin e pastrimit nga 1 Prilli deri më 22 Prill Dita Ndërkombëtare e Tokës;
- Është punuar në grumbullimin dhe sistemimin e informatave për Planin Lokal të Veprimit në Biodiversitet;
- Gjatë gjashtë muajve të fundit janë larguar mbeturina dhe janë eliminuar një numër i madh i deponive ilegale në disa fshatra të Komunës së Vitisë, ku dhe janë aktivizuar një numër i madh i vullnetarëve;
- Në bashkëpunim me MMPH janë vizituar dhe listuar objektet dhe zonat e mbrojtura të natyrës;
- Është punuar në profilin komunal për Planin Zhvillimor Komunal;
- Është punuar në hartimin e Planin e Menaxhimit të Mbeturinave, plani i cili tani është i draftuar dhe është në procedurë për aprovim;
- Jemi në proces të punës për hartimin e Rregullores për Mbeturina, e cila po ashtu është në procedurë për aprovim dhe miratim;
- Në vazhdimësi është bërë vlerësimi i gjendjes mjedisore është bërë grumbullim i informatave nga terreni lidhur me çështjet mjedisore, të cilat janë në një Raport të zgjeruar Mbi Gjendjen e Mjedisit në Komunën e Vitisë;
- Gjatë gjithë muajit prill është bërë aksion për grumbullim të mbeturinave me moton “Pastro dhe Ruaj”. aksioni është zhvilluar në gjitha fshatrat dhe gjatë këtij aktiviteti kanë marrë pjesë rreth 1122 veta dhe janë grumbulluar rreth 1495 thas mbeturinash. Aktiviteti ka përfunduar në qytetin e Vitisë me mbjelljen e luleve dhe drunjeve;
- Në muajin Qershor është shënuar “Dita e Mjedisit” 5 Qershori, ku në bashkëpunim me Drejtorin e Kulturës dhe Shoqatën e Artistëve me një grup artistësh të ri, kanë pikturuar në shëtitoren Viti-Binçe, me temën e mjedisit.
- Në bashkëpunim me Inspektorin e Mjedisit kemi evidentuar 32 deponi ilegale me sasi prej 1090 tonë mbeturinash;
- Në bashkëpunim me komisionin për dhënien e lejeve mjedisore komunale janë shqyrtuar 4 raporte të vlerësimit të ndikimit në mjedis për dhënien e lejeve mjedisore komunale dhe janë lëshuar 4 Leje mjedisore komunale për veprimtari të ndryshme;
- Gjithashtu kemi marr informacione nga kompanitë e shërbimeve publike “Hidromorava” për ujësjellësin dhe “EkoHigjena” e kontraktuar për mirëmbajtjen e qytetit;
- Përgjigje e palëve dhe kërkesave të tyre, sidomos për atë se çka parasheh PZHK dhe PZHU për Zona të ndryshme, duke e zëvendësuar Sektorin e Planifikimit;
- Kemi lëshuar informacione për qytetar dhe grupe tjera te interesit për atë se çka është e paraparë në dokumentet e planifikimit sa i përket fushës së Mjedisit dhe hapësirës;
- Shpallja e vitit 2019, viti i ambientit në Komunën e Vitisë me vendim të Kryetarit të Komunës së Vitisë z.Sokol Haliti.

Zyra e Adresave

Sektori i adresave:

- Ka vendosur pikat referuese të objekteve më rëndësi në qytet dhe disa fshatra;
- Është bërë inspektimi të gjitha tabelave të vendosura për emërtimin e rrugëve;

- ka shqyrtuar 4 kërkesa nga palët për emërtimin e rrugëve të reja, ku të gjitha kërkesave ju ka përgjigj dhe ka dalë dhe verifikuar edhe në teren si dhe ka dhënë përgjigje adekuate pas shqyrtimit të lëndëve;

Gjate kësaj periudhe kohore, si sektor I adresave kemi pasur edhe shumë palë të cilët janë interesuar që të kenë informacione më të shumta rreth sistemit të adresave dhe të marrin informacione për ankesat dhe kërkesat e tyre që kanë bërë për riemërtimin dhe ndryshimin e rrugëve, ku nuk janë shqyrtuar ende nga komisioni dhe kuvendi komunal dhe ne si sektor i adresave jemi munduar që ti informojmë realisht rreth shqetësimeve të tyre sa i përket këtyre çështjeve.

Sfidat :

- Një ndër sfidat kryesore të kësaj drejtorie është pa mundësia e harmonizimit të kërkesave ndërtimore, sepse ekziston një dallim shumë i madhe në mes të PZHK-së, planeve rregulluese dhe kërkesave të qytetarëve për ndërtim.
- Numër i vogël i personelit profesional nga mungon një ndërtimtar, një aktikekt, një specialist i GIS-it dhe një jurist i specializuar për fushën e ndërtimit e që me ligjin mbi administrimin e pushtetit lokal nuk na lejohet rritja e punëtorëve.
- Përfundimi i hartimit të PZHK-së, Hartës Zonale të Komunës dhe ndryshimi i planeve tjera hapësinore.

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Sektori për Bujqësi dhe Blegtori

- Gjatë këtij viti janë bërë vizita të shumta në teren për grumbullimin e shënimeve në ferma, (është bërë rifreskimi i të dhënave mbi gjendjen në përgjithësi në të gjithë sektorët e bujqësisë me të dhëna të reja;
- Hartimi i planeve mujore të vizitave në teren për grumbullimin e shënimeve në ferma;
- Hartimi i planit të mbjelljeve pranverore për vitin 2019, Përcjellja e statistikave bujqësore 19 vizita për këtë qëllim, Kontrollimi i materialit fidanor gjithsej 8;
- Kontrollimi dhe vizita e bletarëve 50;
- Kontrollimi dhe vizita në ferma blegtorale, gjithsej 28 vizita;
- Kontrollimi dhe vizita e pemëve të imta, gjithsej 18 vizita.
- Pranimi dhe plotësimi i formularëve si dhe regjistrimi i pronave të fermerëve për subvencione si: grurë, misër, perime në fushë të hapur, pemë, lopë qumështore, dele, dhi, derra, bletë, qumësht sipas cilësisë dhe pula vojse, ku janë pranuar gjithsej **940 aplikacione, mirëpo ende nuk ka përfunduar afati për aplikim deri me datë 12.07.2019;**
- Gjatë kësaj periudhe janë organizuar mbi 14 trajnime teorike dhe praktike me fermer, nga të gjithë sektorët.

Grandet dhe Subvencionet nga Komuna dhe Donatorët:

Komuna e Vitisë me Organizatën Caritaci Zvicrran :

- Në muajin Qershor, Drejtoria e Bujqësisë ka përkrahur 22 fermer të bletarisë me koshere bletë dhe gjithë mekanizmin e bletarisë;
- 4 fermer janë përkrahur me fidanë të dredhëzës dhe infrastrukturë komplete;
- Janë përkrahur 3 fermer me fidanë të Bimëve Mjekuese Aromatike dhe infrastrukturë komplete (Bashkëfinancim me Caritasin Zvicrran).

Vlera e projektit, 72,000.00 Euro

Komuna e Vitisë dhe Organizata UNDP-ja :

- Në muajin Qershor Komuna e Vitisë ka përkrahur 11 fermer të blegtorisë me laktofriza.

Vlera e projektit, 16,100.00 Euro

Komuna e Vitisë dhe Fondacioni Kosovë-Luxemburg

- Janë përkrahur 3 fermer me Serra 1.5 ari një fermer në Gërmovë dhe 2 fermer në Skifteraj . Vlera 6,030.00€;
- Janë përkrahur 2 fermer në fshatin Skifteraj me serra me sipërfaqe 2.5 ari. Vlera 7,000.00€

Gjithsej Investimi nga Komuna dhe Fondacioni Kosovë-Luxenburg është 13,030.00€

Sektori për Pylltari

- Përgatitja e planit të prerjes;
- Hartimi i planit operativ për mbrojtjen e pyjeve;
- Shqyrtimi i kërkesave për prerje në pyjet private;
- Takime të rregullta me stafin e pylltarisë, realizimi i detyrave të punës;
- Konfiskimi i masave të druve të vëna në qarkullim pa dokumentacionin e nevojshme, ku janë konfiskuar 13.4 m³ dru;
- Gjatë pjesës së parë vitit 2019, janë mbyllur disa rrugë në pyje me qëllim të pengimit të prerjeve ilegale të pyjeve, ku kanë ndikuar mjaftë në zvogëlimin e dëmeve;
- Gjatë vitit 2019 janë mbajtur disa takime me Kryetarin e komunës, Komandantin e Stacionit Policor në Viti dhe Kryetarin e Gjykatës Themelore dega në Viti me qëllim të koordinimit të aktiviteteve për ndalimin e prerjeve ilegale;
- Në bashkëpunim me policinë janë realizuar disa kontrolle rutine në tregje dhe rrugë kyqe, që kanë rezultuar me konfiskim të masës drusore të prerë ilegalisht;
- Gjatë periudhës gjashtëmujore, nga ana e rojeve të pyllit janë bërë gjithsej 49 fletëparaqitje për dëme në pyje.

Të hyrat nga taksat komunale që i përkasin Drejtorisë së Bujqësisë

Duke u bazuar në të hyrat që krijohen nga grumbullimi i taksave komunale, nga domeni i bujqësisë paraqitet kjo gjendje:

Të hyrat nga :

- Ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore në atë ndërtimore, 16,149.00€, dhe
- Certifikata për veprimtari bujqësore, 30 €

Gjithsej të hyra, 16,179.00 €

Shqyrtimi i kërkesave të drejtuara përmes arkivit të komunës

Gjatë këtij gjashtëmujori, nga arkivi i komunës kanë arritur gjithsej 41 kërkesa, prej tyre:

Të bartura nga viti paraprak	Të pranuar Janar-Qershor	Gjithsej të pranuar	Të miratuara	Të refuzuara	Gjithsej të shqyrtuara
/	18	18	17	1	18

Tab.16. Kërkesa përmes arkivit

Kurse, sa i përket kërkesave që i drejtohen drejtorisë pa procedurë të arkivit, numri i tyre është i madh dhe kryesisht kanë të bëjnë me shqyrtimin e mundësisë së subvencionimit të kulturave bujqësore që kultivohen nga ana e tyre.

Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi

Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi, është e rregulluar me një sistemim dhe në bazë të organogramit të brendshëm dhe përshkrimit të detyrave dhe obligimeve të punës të secilit zyrtar, ku aktualisht në këtë drejtori punojnë 9 zyrtar të cilët janë me kualifikimet e nevojshme për ti plotësuar nevojat e punës dhe të funksionimit të secilit sektor në Drejtori.

Në kuadër të DKPGJ-se ekzistojnë tre sektorë:

- Sektori i Kadastrit,
- Sektori i Pronës, dhe
- Sektori i Gjeodezisë.

Sektori i Kadastrit

Puna në Sektorin e Kadastrit është e bazuar në dispozitat ligjore, të cilat e rregullojnë këtë sektor, i cili është përgjegjës për kujdesen dhe mirëmbajtje e të gjitha regjistrave kadastral, ku përfshihet e gjithë paluajtshmeria komunale, si dhe regjistri i paluajtshmerive, hipotekave, servituteve digjitale dhe manual, si shërbim kryesor për qytetarët si shërbimi me lëshimin e fletave poseduese, certifikatave personale dhe social.

Sektori i Pronës

Sektori i pronës ka përgatitë 10 propozim vendime për bordin e drejtoreshë dhe Kuvendin komunal, në lidhje me natyrën e punëve në Drejtori në vazhdimësi ka bërë interpretimin e normave ligjore që janë në fuqi, ka kryer punë administrative në Drejtori; përpilimin e aktvendimeve, urdhëresave dhe akteve tjera, ka lëshuar vërtetime për pronat që komuna nuk ka interes të blejë ato. I ka pranuar kërkesat e drejtuara drejtorisë, i ka shqyrtuar ato dhe ju është përgjigjur me shkrim. Ka zhvilluar procedurat për ekspropoim të tokave në pronësi private për interesa të përgjithshme publike.

Sektori i Gjeodezisë

Sektori i Gjeodezisë për gjatë vitit ka kryer këto shërbime për palët dhe Komunën si: ka mirëmbajt kadastrën digjital në sistemin kosovare f01, ka përcjell vektorizimin e raster planeve, ka përgatitë dhe mbikëqyrë të dhënat për kompanitë dhe gjeodetët e licencuar, ka përgatitë raportet ditore për Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ka pranuar lëndët e kryera nga kompanitë dhe gjeodetët e licencuar dhe të njëjtat i azhurnon në sistemin zyrtar (SIKTK-T dhe SIKTK-G), ka bërë azhurnimin e ndarjeve fizike në librat e regjistrimeve të nëndarjeve kadastrale, ka bërë Hartimin e kopjeve të Planit, Kontroll të vazhdueshme kualitetit të të dhënave grafike kadastrale dhe atyre tekstuale, projektim të rrjeteve referente, të rendit të tretë të shtruar me GPS, Identifikim i parcelave në zyrë. Futja e të dhënave grafike në datamodelin zyrtar (SIKTK-G). Konsulta dhe këshilla profesionale në lëminë e Gjeodezisë dhe Kadastrës, për palët e interesuara në kuadër të shërbimeve kadastrale.

Nr. i punës	E nga terreni i planit		Në aktet për konje/azhurnime		Në aktet e parcelave	
	ag	pa pag	te			
Kadastrë	1	66/3	10	10ndarje/970azhurime	2	1
	1	73/2	12	50 ndarje	5	
	3	130/2	9	9ndarje/25azhurime	1	1
	2	95/2	17	5ndarje/15azhurime	1	2
	1	71/5	20	3ndarje/30azhurime	2	3
Gjeodezi	2	150/4	30	6ndarje/12azhurime	3	2

Tab.17. Shërbimet në sektorin e Gjeodezisë

Të hyrat financiare

Në Drejtorinë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi, planifikimi i të hyrave buxhetore për vitin 2019, duke përfshirë të gjithë sektorët, ka qenë 81,000.00€, kurse realizimi i të hyrave deri në periudhën Janar – Qershor 2019 është 35,705.50€.

Sfidat

Pengesat të cilat i ka përcjell këta Sektorë janë:

- Mungesa e shënimeve prej vitit 1982 – 1999;
- Lidhjet e dobëta digjitale në bazën e të dhënave dhe shpeshherë ndërprerja e tyre kohë pas kohe me Agjencinë Kadastrale të Republikës së Kosovës;
- Mungesa e shënimeve gjeodezike nga viti 1985 – 1999;
- Mungesa e planeve/skicave për zonat kadastrale, të cilat janë pjesë të komasacionit.

Propozim masat të cilat duhet të merren për efikasitet janë:

- Insistimi i faktorëve institucional, vendor dhe ndërkombëtar tek Institucionet e Serbisë për kthimin e shënimeve kadastrale dhe gjeodezike, respektivisht planeve gjeodezike;
 - Insistimi i institucioneve vendore dhe i mekanizmave ndërkombëtar tek institucionet e Serbisë, për kthimin e dokumentacionit kadastral, të konfiskuar (grabitur gjatë luftës);
- Përpjekjet për përmirësimin e lidhjeve digjitale në bazën e të dhënave me Agjencionin Kadastral të Republikës së Kosovës.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Shënimi i aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive Janar-Qershor /2019

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve të saja në fushën e veprimtarisë së saj gjatë gjashtëmujorit të parë 2019, është fokusuar në analizën e performancës të vitit 2018 dhe në realizimin e planit të punës 2019 në sektorët përkatës, sipas raportit të performancës së komunave 2017 (SMPK) të publikuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Në kuadër të DKRS/së, si sektor funksionin edhe **Spektori i Bibliotekës Publike Komunale** me dy bibliotekat amë (për fëmijë dhe të rritur) dhe dy bibliotekat në degë (Pozheran dhe Sllatinë). Gjatë gjashtëmujorit të parë, sektori i bibliotekës përveç shërbimit cilësor dhe aktiviteteve bibliotekare, është fokusuar edhe në pasurimin e fondit. Ajo ka pasuruar fondit e vet me 108 tituj, 577 ekzemplar.

Po ashtu, si sektor në kuadër të DKRS-së funksionin edhe Arkivi Historik.

Spektori i Arkivit Historik ka filluar zbatimin e ligjit të ri për Arkivat Shtetërore Nr.04/L-088, konkretisht nenin 7, e që ka të bëjë me dhënien e certifikatave dhe dëftesave për shkolla të mesme. Krahas këtij ligji, gjithashtu si pjesë e pandarë fillon se aplikuari edhe neni 38 i Procedurës Administrative, e cila rregullon në detaje të drejtat dhe obligimet e palëve që janë pjesëmarrëse në këtë procedure. Përveç punëve rutinë, shërbimit cilësor dhe përgjegjës në kërkesa nga palët brenda afateve ligjore, është hartuar evidenca e të gjitha regjistraturave aktive dhe pasive që janë regjistruar në territorin në Komunës së Vitisë.

Arkivi historik gjatë gjashtëmujorit të parë ka pranuar 104 kërkesa. Të realizuara janë 74, ndërsa të porealizuara 30.

Kalendari i aktiviteteve (te mbështetura dhe te realizuara) Janar - Qershor 2019:

Sektori i Kulturës, Rinise dhe Sportit:

MUAJI	NGJARJA	AGJENDA E AKTIVITETEVE TE REALIZUARA
JANAR	Analizë e punës së Drejtorisë për Kulturë, Rinë dhe Sport për vitin 2018 Zgjedhja e Artistit të vitit 2018 Hartimi i planit të punës për vitin 2019 Hartimi i projektit të manifestimit tradicional kulturor "Flakadani i Karadakut"-2019 Hartimi i projektit "Festivali Ndërkombëtar i Fotografisë" në Viti. Hartimi i projektit "Ditët e skenës teatrore" në Viti Hartimi i projektit: "1 Gushti dita e Mërgimtarëve" Manifestimi kulturor "Flaka e Janarit" Konsultë me grupet kulturore e artistike Bashkëpunimi me KFOK/LMT për vitin 2018 Bashkëpunimi me organizata te huaja	- Raportet dhe planet e punës për vitin 2018 - Kemi hartuar planin punës për vitin 2019 - Kemi hartuar i projektin për manifestimin tradicional kulturor "Flakadani i Karadakut – 2019" - Hartimi i projektit "Festivali Ndërkombëtar i Fotografisë" në Viti. - Kemi bërë projektin "Ditët e skenës teatrore" në Viti - Kemi bërë projektin për manifestimin tradicional: "Ditë e Diasporës" - Manifestimi kulturor "Flaka e Janarit" - Kemi zhvilluar takime pune dhe konsultime me grupet kulturore e artistike të Komunës së Vitisë - Më 32.01.2019, u bë zgjedhja e personalitetit të vitit 2018 - Aktivitete të përbashkëta, sportive, kulturore dhe edukative si dhe vizita në Bondsteel - Më 09,10 & 11.01.2019, Kemi trajnime për ciklin e menaxhimit të projekteve me OJQ- të Kulturore në bashkëpunim Komision Evropian, UNDP – ReLoAd. - Investime Kapitale MKRS-DKRS, Komuna ne infrastrukturën sportive: Stadiumi i Vitis, Pozhoranit dhe Sodovina e Jerlive

SHKURT	<i>17 Shkurti, 11 vjetori i Pavarësisë së Republikës së Kosovës</i> <i>Shkurt 2019</i> <i>Konkursi publik për Subvencionim të OJQ-ve</i>	- <i>Me rastin e 11 vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës, sipas agjendës së DKRS, janë zhvilluar këto aktivitete:</i> - <i>Me 05.02.2019 është mbajtur Konferenca shkencore me rastin e 11 Vjetorit të Pavarësisë së Kosovës si dhe 110 vjetorit të fillimit të Shkollës së Parë Shqipe me alfabet të Kongresit të Manastirit.</i> • <i>Më 17.02, 2018, homazhe tek varrezat e dëshmorëve</i> • <i>Seancë solemne – Kuvendi i Komunës</i> • <i>Koncerti artistik për Ditën e Pavarësisë</i> • <i>U dha shfaqja e filmit dokumentar “Pabesia”</i> • <i>Turnir i organizuar për nderë të 17shkurtit në:</i> - <i>Futboll, Volejboll (F)</i> - <i>Basketboll</i> - <i>Atletik</i> • <i>Shënimi i 14 Shkurtit, Ditës së Shën Valentinit Trajnime me OJQ dhe grupet artistike për projektin “Reload”</i>
MARS	<i>21-26 Mars, “Flakadani i Karadakut</i> <i>07.03.2019, u shënua Dita e Mësuesit</i> <i>08.03.2019, u shënua Marsi Dita e Gruas</i> <i>Promovim te librit dhe shfaqje Filmi</i> <i>29.03.2019 Perurimi i Stadiumit ne Sodovine</i>	<i>Kemi organizuar manifestimin gjithëkombëtar tradicional kulturor dhe sportiv “ Flakadani i Karadakut 2019”</i> <i>Në kuadër të cilit janë zhvilluar aktivitete të shumta kulturore:</i> • <i>Më 20.03.2019, u organizua Konferencë për shtyp.</i> • <i>Më 21.03.2019, Hapja e manifestimit – ndezja e Flakadanit</i> • <i>Më 21.03.2019, Ekspozita e manifestimit</i> • <i>Më 22.03.2019, Garat regjionale të recituesve</i> • <i>Më 23.03.2019, Ora e madhe letrare</i>

	<i>Rinovimi i muralit PIMI PHOTOGRAFI</i>	• <i>Gara ne Futeboll, gara ne shah, gara ne pingpong</i> • <i>Më 24, 25 & 26.03.2018, Festivali Gjithëkombëtar i ansambleve kulturore "Flakadani i Karadakut 2019"</i> • <i>07.03.2019, u shënua Dita e Mësuesit</i> • <i>08.03.2019, u shënua Marsi Dita e Gruas</i> • <i>29.03.2019 Perurimi i Stadiumit ne Sodovine</i> • <i>Më 14.03.2019, u bë promovimi i librit "Tahir Berisha Veprimtar i Arsimit", të autorëve Mujë Berisha dhe Hamzë Halabaku,</i> • <i>Shfaqja e Filmit Dokumentar "Zvicra ", në bashkëpunim me Ambasadën zvicerane.</i> • <i>DKRS eshte pjese në grupin punues për hartimin e Planit Zhvillimor Urban – Trashëgimia Kulturore</i>
PRILL	<i>Pjesëmarrja në manifestimet e ndryshme kulturore vendore dhe më gjerë, shënimi i datave historike dhe mbështetja e aktiviteteve kulturore të lokaliteteve të Komunës së Vitisë.</i> ▪ <i>Festivali "Lulëkuqet e prillit" – Dardanë</i> ▪ <i>Përgatitja e SHKA-ve për manifestimet jashtë Komunës</i> ▪ <i>Datat me rëndësi kulturore dhe historike</i> ▪ <i>3 Prilli, përvjetori i rënies së dëshmorit Sherif Frangu – Akademi Përkujtimore</i> ▪ <i>08 Prilli, Dita e Kushtetutës së RKS-së</i> ▪ <i>18 Prilli, Dita Ndërkombëtare e T. Kulturore</i>	- <i>Mbështetja e aktiviteteve kulturore edhe nëpër lokalitete të komunës së Vitisë.</i> - <i>Marrja pjesë në manifestimet tradicionale kulturore</i> • <i>Festivali "Lulëkuqet e prillit" – Dardanë</i> • <i>Përgatitja e SHKA-ve për manifestimet jashtë Komunës</i> • <i>3 Prilli, përvjetori i rënies së dëshmorit Sherif Frangu – Akademi Përkujtimore</i> • <i>Më 18.04.2019, me rastin e Ditës Botërore t trashëgimisë Kulturore kemi organizuar Tryezën e rrumbullakët me teme: "Trashëgimia Kulturore si Vlerë dhe pjesë e zhvillimit të Turizmit Kulturor"</i>

	▪ 19 Prilli, përvjetori i rënies së dëshmorit Mejdi Korrani ▪ 23.04.2019 Dita botrore e Librit ▪ 26 Prill Java e arkivit ▪ 27 Prilli, Dita e të pagjeturve – Ekspozitë ▪ Promovime kulturore, panairi kulturor, shfaqje teatrore ▪ 24 Prill Denim Day ▪ Ndërtimi dhe renovimi i 5 fushave sportive	• 23.04.2019 është mbajtur Dita botërore e Librit, me ligjëratë mbi Librin nga autor të komunës së Vitisë • 8 Prilli, Dita e Kushtetutës së RKS-së • 19 Prilli, përvjetori i rënies së dëshmorit Mejdi Korrani– Koncert në ambient të hapur për qytetarë në fshatin Pozheran dhe gara sportive • Me 26.04.2019 u shënua java e Arkivit në ambientet e DKRS • Investimet kapitale në SPORT në ndërtimin e 5 fushave sportive në Pozheran, Remnik, Beguncë, Skifleraj dhe shkollat e mesme • Shfaqje e filmit artistik “Miqë të sotëm” • 22 Prilli – Dita Botërore e Tokës-Shtegtim me Bicikleta për Senior shtegu: Viti- Kabash - Binçë-Viti. Vendosja e mesazheve në park nga fëmijët e shkollës OKSFORD, KVRL dhe Kryqi i Kuq. Shtegtim me Bicikleta për fëmijë. Shtegu: 400m rreth parkut • 24.04.2019 u mbajtur Dita e fermerkave apo Denim Day në bashkëpunim me Kforin me një takim të përbashkët të institucioneve, me mesazhe simbolizuese për mos abuzimin e grave, muzikë dhe koktej, si dhe shfaqja e filmit të shkurtër artistik “Rruga” kundër dhunës familjare
MAJ	3 Maji, Dita Botërore e Lirisë së Shtypit 5 Maji, Dita e Dëshmorëve të Vitisë 9 Maji Dita e BE-së – Tryez e rrumbullaket Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Muzeut	- Promovimi kulturor dhe pjesëmarrja në manifestimet e ndryshme kulturore • Më 03.05.2018, me rastin e Ditës së gazetarëve, kemi bërë me temë: “Liria e Shprehjes në komunën e Vitisë” • Pjesëmarrja me G. A. në festivalet të cilat organizohen në Klinë dhe Deqan dhe Komoran. • Më 05.05.2018, shënimi i 5 Majit, Ditës së Dëshmorëve në Komunën e Vitisë. • Seanca solemne

	Promovim i artistëve, trashëgimia kulturore 26.Maj Manifestimi Jubilar per deshmorin Bafti Haxhiu Rishpallje e Thirrjes publike për subvencione për OJQ-të	• Akademi perkujtimore dhe shfaqja e dokumentarit "Kronologji e biografisë së dëshmorëve të Vitisë", Turnir tradicional ne futboll • 9 Majit Dita e BE-së. – Tryez e rrumbullake me tem " Kosova dhe Integrimet Evropiane " • Me 24.05.2019 është mbajtur takimi i tret i forumit lokal te trashëgimi kulturore –KOMUNA E Vitisë e organizuar nga CHëB Kosov • Manifestimi jubilar i dëshmorit Bafti Haxhiu-Shtegtim me motorë: Viti – Suharekë – Lndovicë – Gorozhup – Koshare .Gara nacionale në Shah në bashkëpunim me Federatën e Shahut. Turne në Futboll të madh i në Sadovin J,shpalosja e shtatores se dëshmorit
QERSHOR	Manifestimi kulturor, kushtuar 14 Qershorit, vizita të ndryshme me grupet artistike dhe pjesëmarrja në evenimentet kulturore të vendit dhe më gjerë. 1 Qershori – Dita ndërkombëtare e fëmijëve Implementim 20-22 Ditët e sekenes Teatrorë	▪ Programi i pasur kulturor dhe artistik ▪ Aktivitete të tjera kulturore ▪ Vizitë e grupeve artistike nga Vitia, komunave të tjera si dhe Shqipërisë ▪ Pjesëmarrja me SHKA-të në festivalin e Tiranës ,Bajram Curr, Shkup • Pjesëmarrja e G. Artistike në festivalet e Dejës, Kaçanikut dhe Tropojës. • Më 31.06.2019,Zyrtar rinor, nxënës nga ShMU do të udhëheq me sektorin e rinisë, nga Pozherani. Grupi i nxënësve viziton institucionet komunale: Policinë, Gjykatën, Kryetarin, Kuvendin, etj. Çerdhja e Fëmijëve "Gëzimi Ynë"- program argëtues për fëmijë, 01.06.2019 -Koncert për fëmijë me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve • Shfaqje e filmit artistik për fëmijë. • Më 05.06.2019 akademi perkujtimore për nder te dëshmorit Kemajl Azizi – Viti • 07.06.2019 teatri "Pinokio" nga Tetova mbajti shfaqje për fëmija • Më 14.06.2018, homazhe dhe mbajtja e koncertit me defileun e grupeve artistike, bizneseve,grupeve sportive institucioneve publike si dhe shpallja qytetar nderi për ish

		presidentet Bujar Nishani dhe Atifete Jajaga , me rastin e Ditës së Çlirimit të Vitisë si dhe video material për veprën jetësore të Xhelil Muses • Vizitë e grupeve artistike nga Vitia, komunave të tjera si dhe Shqipërisë • Puna në terren rreth T. Kulturore • Promovimi i dy librave "Sllatina e e perime e Anamoraves" me autor Dr Fahrush Rexhepi dhe Dr Jusuf Osmani • Libri "Çausi i Smirës" nga Autori Nazif Laci • Shfaqja e komedisë "Vrapo pas gruas tende" Teatri i Gjilanit • Shfaqja e komedisë " Kopr rac" Teatri i Ferizajt • Shfaqja e komedisë "Vëllazëri e interes. • Fillimi i garave tradicionale "2 Korriku" • Shpallja e OJQ-ve përfituese të subvencionimeve të Drejtorisë • Diskutim publik i propozim rregullores për menaxhimin e objekteve sportive komunale
--	--	--

Tab.18. Kalendari i aktiviteteve (te mbështetura dhe te realizuaru) Janar - Qershor 2019

P.s. në kalendarë janë të përfshira aktivitetet kulturore, pa inkorporim të takimeve në realizimin e këtyre aktiviteteve

Pasqyra tabelare e aktiviteteve të mbajtura në Shtëpinë e Kulturës, në periudhën Janar - Qershor/2019								
	titucionet kom	OJQ-të	Ekspozitaromovimi i l		-Çfaqje filmi -Dokumentar -Teatri-Baleti	Partitë politike	Personat për (Libri)	Gjithëse
Numri i aktiviteteve	45	66	2	3	8	1	2	127
Numri i pjesëmarrës	4185	2085	100	270	900	200	50	0
Orët e punës gjatë orarit shtesë të aktiviteteve të lartshënuara								
Orët shtesë	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Gjithsej	
Orët	-/-	-/-	-/-	-/-	-/-	-/-	-/-	

Tab.19. Aktiviteteve të mbajtura në Shtëpinë e Kulturës, në periudhën Janar - Qershor/2019

Shpërndarja e Subvencioneve:

(Nga kodi buxhetor subvencione i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe nga Kodi buxhetor Subvencione i kryetarit të Komunës)

	<i>Përshkrimi i shpenzimit</i>	<i>Vendi</i>	<i>Kategoria e shpenzimit</i>	<i>Shuma €</i>
1	Ansambl i Këngëve dhe Valleve "Kemajl Azizi"	Viti	Subvencion	1,750.00€
2	OJQ Q.K. "Anamorava"	Viti	Subvencion	2,500.00€
3	Klubi I Ping pongut "Vitia"	Viti	Subvencion	1,000.00 €
4	Klubi i Shahut "Vitia"	Viti	Subvencion	1,150.00€
5	K. Shenjëtarisë "Anamorava"	Viti	Subvencion	1,160.00€
6	SHKA "Jonuz Ramdani"	Smirë	Subvencion	1,920.00€
7	AKV "Vitia"	Viti	Subvencion	1,650.00€
8	Klubi i gjimnastikës "Halil Alidema"	Pozheran	Subvencion	3000.00€
9	EULOK	Viti	Subvencion	2,000.00€
10	KF "Vllaznia"	Pozheran	Subvencion	10,870.00€
11	KVRL	Viti	Subvencion	1,325.00€
12	Kori I Qytetit	Viti	Subvencion	1,200.00€
13	TVP "8Plus"	Viti	Subvencion	1,225.00€
14	Tingulli Fest	Viti	Subvencion	1,300.00€
15	Shkolla e futbollit "Kosova"	Viti		750.00€

TOTALI:30,298.00

Tab.20. Shpërndarja e Subvencioneve

Projektet e Përfituara:

a) Projektet e Implementuara:

Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport, 2.500.00€ në pasurimin e fondit Bibliotekar.

Donatorët e Bibliotekës: Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport, Prof. Dr. Isak Shema, Ramadan Musliu, Nazif Laci, Xhevat Bislimi, Halil Alidema, Selman Mehaj, Tefta Dedaj.

Pasurimi i Fondit Librar, 108 tituj, 577 ekzemplar.

b) Projekte të Planifikuara të fillojnë implementimin në gjashtëmujorin e dytë:

Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport: Participim me Komisionin Evropian për Renovimin e Shtëpisë së Kulturës.

Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport: Palestra Sportive në Drobesh.

European Commission: Projekti i renovimit të Shtëpisë së Kulturës.

Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport: Vazhdimi i punimeve të stadiumit "Ibrahim Kurteshi" në Pozhoran.

Viti, Korrik 2019

Kryetari i Komunës
Sokol HALITI



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA - MUNICIPAL VITINA

Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-qershor 2019

Viti 15.07.2019



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA - MUNICIPAL VITINA



DREJTORIA E FINANCAVE

Data/Datum/Date	15.07.2019
Nr/Br.	
Për/Za/To	Kuvendin e Komunës, Komitetin për Politikë dhe Financa
Përmes/Preko/Through	Z. Sokol Haliti, Kryetar i Komunës
Nga/Od/From	Z. Ibrahim Rama, Drejtor i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim
Lënda/Predmet/Subject	Pasqyrat Financiare për periudhën janar-qershor 2019

Bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin mbi Financat Lokale si dhe Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë paraqesim pasqyrat financiare të organizatës sonë buxhetore (657) për periudhën janar-qershor 2019 përfshirë të hyrat vetanake të realizuara si dhe shpenzimet buxhetore për të gjitha kategoritë ekonomike.

Të hyrat

Gjatë periudhës janar – qershor 2019 janë inkasuar gjithsej të hyra vetanake në vlerë prej 481.931,81€, shkalla e inkasimit, duke u bazuar në planifikimin vjetor është 46,21%, ndërsa krahasuar me të hyrat për periudhën janar – qershor të vitit 2018 të hyrat e vitit 2019 janë me të larta për 139.030,64 €

Shpenzimet Buxhetore

Buxheti i Alokuar për periudhën janar – qershor të vitit 2019 nga fondet burimore: Granti qeveritar, të hyrat vetanake, dhe donacionet janë: 6.379.436,62€, ndërsa shpenzimet janë: 5.025.216,25€, shkalla e ekzekutimit të buxhetit për periudhën janar- qershor 2019 është 78,77% në krahasim me Alokimet për të gjitha programet dhe kategoritë ekonomike.

Në vazhdim të këtyre pasqyrave në mënyrë tabelare do të paraqesim shpenzimet buxhetore, duke i specifikuar sipas burimeve të financimit, programeve dhe kategorive Ekonomike.

Buxheti i Aprovuar,Alokuar dhe i shpenzuar per te Gjitha programet buxhetore - janar-qershor 2019

Aprovim						
	Kateg.&Ekonomik	Aprovime 10	Aprovime 21	Aprovimet 22	Aprovimet Donacionet	Totali i Aprovimeve
1	Pagat &Shtesat	7,363,560.99	0.00	1,500.00	1,098.25	7,366,159.24
2	Mall.&Sherbime	1,124,236.00	244,698.00	26,229.73	5,658.08	1,400,821.81
3	Komunali	221,000.00	0.00	0.00	0.00	221,000.00
4	Subvencione	0.00	210,000.00	14,081.57	14.31	224,095.88
5	Kapitale	1,535,012.00	588,275.00	63,954.01	69,798.72	2,257,039.73
		10,243,808.99	1,042,973.00	105,765.31	76,569.36	11,469,116.66

Alokimet						
	Kateg.&Ekonomik	Alokimet 10	Alokimet 21	Alokimet22	Alokimet Donacionet	Totali i Alokimeve
1	Pagat &Shtesat	3,625,892.77	0.00	1,500.00	1,098.25	3,628,491.02
2	Mall.&Sherbime	690,626.28	73,883.43	26,229.73	5,658.08	796,397.52
3	Komunali	146,543.64	0.00	0.00	0.00	146,543.64
4	Subvencione	0.00	95,559.00	14,081.57	14.31	109,654.88
5	Kapitale	1,357,355.00	207,241.83	63,954.01	69,798.72	1,698,349.56
		5,820,417.69	376,684.26	105,765.31	76,569.36	6,379,436.62

Te paalokuara						
	Kateg.&Ekonomik	Alokimet 10	Alokimet 21	Alokimet22	Alokimet Donacionet	Totali i Alokimeve
1	Pagat &Shtesat	3,737,668.22	0.00	0.00	0.00	3,737,668.22
2	Mall.&Sherbime	433,609.72	170,814.57	0.00	0.00	604,424.29
3	Komunali	74,456.36	0.00	0.00	0.00	74,456.36
4	Subvencione	0.00	114,441.00	0.00	0.00	114,441.00
5	Kapitale	177,657.00	381,033.17	0.00	0.00	558,690.17
		4,423,391.30	666,288.74	0.00	0.00	5,089,680.04

Shpenzimet							
	Kateg.&Ekonomik	Shpenzimet 10	Shpenzimet 21	Shpenzimet 22	Shpenzimet Donacionet	Totali i Shpenzimeve	% shpenzimit
1	Pagat &Shtesat	3,625,892.77	0.00	0.00	0.00	3,625,892.77	99.93%
2	Mall.&Sherbime	488,858.42	36,684.56	16,201.64	0.00	541,744.62	68.02%
3	Komunali	139,134.50	0.00	0.00	0.00	139,134.50	94.94%
4	Subvencione	0.00	64,358.00	5,800.00	0.00	70,158.00	63.98%
5	Kapitale	610,074.08	0.00	17,727.38	20,484.90	648,286.36	38.17%
		4,863,959.77	101,042.56	39,729.02	20,484.90	5,025,216.25	78.77%

Diferenca Alokim-Shpenzim						
	Kateg.&Ekonomik	Shpenzimet 10	Shpenzimet 21	Shpenzimet 22	Shpenzimet Donacionet	Totali i Shpenzimeve
1	Pagat &Shtesat	0.00	0.00	1,500.00	1,098.25	2,598.25
2	Mall.&Sherbime	201,767.86	37,198.87	10,028.09	5,658.08	254,652.90
3	Komunali	7,409.14	0.00	0.00	0.00	7,409.14
4	Subvencione	0.00	31,201.00	8,281.57	14.31	39,496.88
5	Kapitale	747,280.92	207,241.83	46,226.63	49,313.82	1,050,063.20
		956,457.92	275,641.70	66,036.29	56,084.46	1,354,220.37

Diferenca Aprovim-Shpenzim						
	Kateg.&Ekonomik	Shpenzimet 10	Shpenzimet 21	Shpenzimet 22	Shpenzimet Donacionet	Totali i Shpenzimeve
1	Pagat &Shtesat	3,737,668.22	0.00	1,500.00	1,098.25	3,740,266.47
2	Mall.&Sherbime	635,377.58	208,013.44	10,028.09	5,658.08	859,077.19
3	Komunali	81,865.50	0.00	0.00	0.00	81,865.50
4	Subvencione	0.00	145,642.00	8,281.57	14.31	153,937.88
5	Kapitale	924,937.92	588,275.00	46,226.63	49,313.82	1,608,753.37
		5,379,849.22	941,930.44	66,036.29	56,084.46	6,443,900.41

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit për të gjitha njësit buxhetore

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxneut	Shpenzimet	Buxheti i pa snpenzuar	Alokimi i pa snpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	7,366,159.24	3,628,491.02	3,625,892.77	3,740,266.47	2,598.25	99.93%
2	Mailra dhe shërbime	1,400,821.81	796,397.52	541,744.62	859,077.19	254,652.90	68.02%
3	Subvencione	224,095.88	109,654.88	70,158.00	153,937.88	39,496.88	63.98%
4	Komunal	221,000.00	146,543.64	139,134.50	81,865.50	7,409.14	94.94%
5	Shpenzime kapitale	2,257,039.73	1,698,349.56	648,286.36	1,608,753.37	1,050,063.20	38.17%
	Gjithesëjt	11,469,116.66 €	6,379,436.62 €	5,025,216.25 €	6,443,900.41 €	1,354,220.37 €	78.77%

Shpenzimet për të gjitha njësit buxhetore

Kodi	Përshkrimi	Shuma
11110	Paga neto	3,084,187.70
11500	Talimi në paga	179,249.36
11600	Kontributi i punëtorit	172,235.79
11700	Kontributi i punëdhënsit	172,235.79
11115	Sindikata	15,036.82
11125	OIK	1,027.31
11126	OMK	1,920.00
	Totali i pagave	3,625,892.77
13130	Shpenzimet e udhëtimit mbrenda vendit	13,612.08
13132	Akomodimi gjatë udhëtimit zyrtar mbrenda vendit	1,267.20
13140	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	6,029.90
13141	Meditjet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	1,331.68
13210	Shpenzimet e rrymës	100,586.50
13220	Shpenzimet e ujit	16,190.15
13230	Shpenzimet e mbeturinave	12,793.99
13250	Shpenzimet e telefonis fikse	6,307.11
13310	Shpenzimet per internet	1,173.41
13320	Shpenzimet e telefonis mobile	7,455.76
13330	Shpenzimet postare	16.90
13430	Sherbime te ndryshme shendetesore	44,109.28
31000	Investime Kapitale	646,906.70	62,981.27	528,300.89	591,282.16	-55,624.54
34000	Pagesa-vendime gjyqesore	83,771.75	57,004.20		57,004.20	-26,767.55
Tatall i investimeve kapitale		730,678.45	119,985.47	528,300.89	648,286.36	-82,392.09
Gjithsej shpenzimet		5,090,573.80	305,279.80	4,719,936.45	5,025,216.25	-65,357.55

Komente:

Shpenzimet në vitin 2019 në total janë 5,025,216.25€, që nga kjo shum 305,279.80€ janë paguar obligimet e vitit 2018 dhe 4,719,936.45€ janë Shpenzime të vitit 2019. Ndërsa Shpenzimet në vitin 2018 kanë qenë 5,090,573.80€

Në shpenzime janë përfshirë pagat dhe medijet, shërbime mallra dhe shpenzimet komunale, subvencione dhe transfera dhe investime kapitale

Shpenzimet për Paga dhe medijet të vitit 2019 janë më të larta për 47,827.25€ në krahasim me vitin 2018

Shpenzimet për shërbime mallra dhe komunali të vitit 2019 janë më të larta për 48,818.74€ në krahasim me shpenzimet e vitit 2018

Shpenzimet për subvencione dhe transfera të vitit 2019 janë më të ulta për 79,611.45€ në krahasim me shpenzimet e vitit 2018

Shpenzimet për Investime kapitale të vitit 2019 janë më të ulta për 82,392.09€ në krahasim me shpenzimet e vitit 2018.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA			
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA			
Pranuar - Prilapje: 17.07.2019			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtetçi Prilog	Vlera Vendos
02-035/02		765	



Republika e Kosovës

Republic of Kosova

Komuna e Vitisë

Municipality of Viti/Vitina

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Department of Culture, Youth and Sports

Për: KUVENDIN KOMUNAL TË VITISË

Nga: Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport

Në mbështetje të nenit 58, pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 4 pika 3 të Ligjit për Teatrot nr.4 L-106, rregullorës nr. 04/2015 (MKRS) për kushtet dhe kriteret e themelimit të teatrove kombëtare dhe të teatrove të qyteteve, Kryetari i Komunës, bënë këtë:

PROPOZIM – VENDIM

Për iniciimin e themelimit të Teatrit të Qytetit

1. Të inicohet procedura për zyrtarizimin e Teatrit të Qytetit si Institucion publik.
2. Procedurat e zyrtarizimit të Teatrit të Qytetit, do të zhvillohen sipas kriterëve të përcaktuara në Rregulloren nr. 04/2015 (MKRS), për kushtet dhe kriteret e themelimit të teatrove kombëtare dhe të teatrove të qyteteve, përkatësisht pas vlerësimit profesional të Komisionit të veçantë të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sport.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të përkujdesen: Drejtoria e Kulturës dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.
4. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës.
5. Me këtë Vendim njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe Arkiva.

Viti: 17.07.2019

Kryetari i Komunës:

Sokol Haliti





KËRKESË

Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport- Përgjegjësi për kulturë , si dhe Aktorët e Teatrit të Qytetit të Vitisë, që funksionon si OJQ "Teatri i Qytetit", i parashtrajnë kërkesë Kuvendit Komunal të Vitisë, që të shqyrtoj mundësit për zyrtarizmin e kësaj Trupe teatrore, bazuar në kërkesat edhe të Shoqërisë Civile dhe nevojës që në komunën e Vitisë të funksionoj teatri sipas ligjeve në fuqi. –Ligji për teatrot, neni 4, që parasheh themelimin e teatrove komunale.

Arsyetim

Teatri i Qytetit të Vitisë funksionon që nga viti 1993/94, por atëherë ishte themeluar si Grup i Dramës i emëruar "Yjet nën Re". Ky grup, në rrethana të atëhershme të okupimit, së bashku me SHKA "Lajmëtari" dhe SHKA "Liria" nga Sllatina , mbajtën gjallë jetën kulturore në komunën e Vitisë. Grupi i dramës funksionoj si i tillë, duke realizuar me dhjetëra shfaqje Brenda territorit të komunës së Vitisë, por edhe në komunat tjera. Paraqitja e anëtarëve të këtij grupi, ishte mirëpritur shumë nga publiku, ku edhe kanë marrë çmime e shpërblime të ndryshme. Si tillë, ky grup ka funksionuar edhe pas lufte, deri më 24.06.2008 kur është shndërruar si OJQ "Teatri i Qytetit të Vitisë". Që nga paslufta, Teatri i Qytetit ka realizuar shfaqjet : Audicioni", Me faqe të zeze", Njerëzit me Maska", Mysafiri i Mallkuar", Romeot dhe Xhylieta" si dhe së fundmi komedinë "Vëllazeri e Interes".

Aktorët e teatrit të cilët kanë qenë pjesë e shfaqjeve të kësaj trupe për vite me radhë:

Agron Abazi

Sadri Rexhepi

Avdi Lutfiu

Blerim Bajrami

Përparim Zeqiri

Florim Zeqiri

Naser Abazi

Labëria Ibrahim

Afrim Ymeri

Fjolla Selmani

Andaj, për këtë propozim tonin, shpresojmë lartë tek autoriteti juaj në miratimin e këtij propozim vendimi.

Viti, 17.07.2019

Drejtoria për Kulturë Rinë e Sport

 3/08

/Milot Lala/



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË • OPŠTINA VITINA

Pranuar: Preraportimi			
Nr./i organit	Mundësi/Broj	Shtetësi	Vlera
Org. broj		Prilog	Uredina
17-07-2019			
02-052/41-768			

Komuna e Vitisë

Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim

Informatë lidhur me Raportin e auditimit për Pasqyrat Financiare të Komunës së Vitisë për vitin e përfunduar më 31.12.2018

Duke u bazuar në Ligjin mbi Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Ligji Nr. 03/L-048 (plotësim ndryshimet në Ligjin Nr.03/L-221 ,Ligjin nr.04/L-116, Ligjin nr .04/L-194, Ligjin nr .05/L-063, Ligjin nr. 05/L-007) Neni 45 dhe neni 46 (neni 46 paragrafi 46.2) që obligojnë organizatat buxhetore të përgatisin Raporte tremujore respektivisht raport përfundimtar për vitin e kaluar kalendarik.

Mandej duke u bazuar në Rregulloren MF-NR.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga organizatat buxhetore – Neni 4 obligimet e raportimit të organizatave buxhetore (Organizatat Buxhetore janë të obliguara të përgatisin dhe të dorëzojnë Pasqyrat Vjetore Financiare në MF-Departamentin e thesarit , Neni 5 afatet kohore për dorëzimin e Pasqyrave Financiare Vjetore dorëzohen brenda afatit prej 30 ditë nga përfundimi i vitit fiskal në formë të shtypur dhe në formën elektronike.

Në si drejtori ju kemi përmbajtur Ligjit dhe rregullores në fuqi dhe i kemi përgatitur duke u bazuar në regjistrin kontabël të thesarit në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik e dorëzuar në kohë më 30.01.2019.

Auditimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin e përfunduar Janar-Dhjetor 2018 e ka kryer „ Zyra Kombëtare e Auditimit, ka filluar auditimin në muajin tetor dy ditë, në muajin nëntor 10 ditë dhe në muajin prill 10 ditë (auditori i ZKA-së Svetlana Perović – udhëheqës i ekipit ,Mehmet Kurti-auditor, Agim Sogojeva – auditor dhe Milosh Petrović – auditor , nën menagjimin e udhëheqësit të departamentit të auditimit Luljeta Morina kurse raporti përfundimtar është dorëzuar në Komunë me datë 21.06.2019 .

Zyra e kombëtare e auditimit është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar , kryen auditime të rregullsis dhe të performancës, që është në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Instruconeve Supreme të Auditimit (SNAISA - faqe 2).

Misioni i ZKA-së është që të kontribojmë në menagjim të shëndosh financiar në administratën publike , ndërton besim në shpenzimin e fondeve publike dhe lajnë një rol aktiv për rritje të llagaridhënjes së institucioneve publike .

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e RVF për vitin 2018 i cili e përcakton OPINIONIN e dhënë nga auditori i përgjithshëm i cili pasqyron drejt për së drejti cilësin e kontrollit të mbrendshëm të përcaktuar nga menagjmenti.

Auditori është fokusuar në :

PVF - Menaxhimi financiar dhe kontrolli dhe rekomandimet e vitit paraparak

OPINIONI – është një pasqyrim i të gjeturave të audituara

Format e Opinionit (vlerësimit) janë si :

Opinion i pa modifikuar - auditori jep këtë opinion nëse vjen në përfundim se pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Por nëse ka të gjetura që nuk pasqyrojnë anomali materiale atëher ipet vlerësimi opinion i i pakualifikuar me theksim gjetjesh që për të tërhequr vëmendjen për çështjen e theksuar me rekomadim të përmirësimi gjat përgatitjes së PVF në vitin e ardhshëm .

Opinion i modifikuar - nëse pasqyrat financiare nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë atëher jepet vlerësimi i modifikuar- i zaveëndësuar me kualifikim të kualifikuar .

Mohim i opinionit - kur në dëshmit e marra të auditimit arrin në përfundim se pasqyrat financiare në tërësi përmbajnë gabime materiale ose nuk ka mund të marr dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshatshme ,ku auditori vjen në përfundim se efektet e çdo gabimi të pa zbuluar mund të jenë materiale , nuk ka material bazë për të vlerësuar fare .

Opinion i auditorit për PVF për vitin 2018

Ne besojmë se evidencia e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Opinion i auditorit „ OPINION I PAMODIFIKUAR “ bazë për këtë opinion :

Pasqyrat Financiare për vitin 2018 paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale

Auditimin është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Intitucioneve Supreme të Auditimit (SNISA), besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion (faqe 7) dhe janë në përputhje me *Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në parandë e gatshme)* , Ligji nr. 03/L-048 për *Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi (me plotësi dhe ndryshime) dhe rregulloren e MF – Nr. 01/2017 për raportimin vijtor financiar të organizatave buxhetore”*.

Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit

Menagjimenti i komunës ka projektuar dhe zbatuar një sistem të kontrolleve të mbrendshme por disa kontrole të administrimit nuk operojnë në mënyrë efektive duke identifikuar këto rekomandime dhe Kryetari duhet të siguroj për të gjeturat :

1.Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

E gjetura Kemi identifikuar disa gabime në shpalosjet në PFV-të siç janë:

■ Neni 17, Raporti për detyrimet e paguara, ka përfshirë detyrimet në shumë prej 11,419 €, edhe pse ato ishin paguar, dhe në atë mënyrë ishte mbivlerësuar shuma e detyrimeve të përgjithshme;

■ Nuk janë prezantuar dhe shpalosur drejthe shpenzimet në vlerë prej 9,308€ sipas kategorive ekonomike për shkak të pagesave të vendimeve gjyqësore dhe të ekzekutuar direkt nga thesari.

Rekomandimi Kryetari duhet të siguroj se plani i përpilimit të PFV-së për vitin 2019 i adreson të gjitha çështjet të cilat janë cekur në lidhje me pajueshmërinë e PFV-të, dhe është bërë analiza për përcaktimin e arsyeve për prezantimin jo të plotë të detyrimeve dhe klasifikimin e drejt të shpenzimeve në PFV-të dhe të sigurojë se janë vendosur proceset efektive për një shpalosje të drejt në të ardhmen

2.Keq-klasifikim i shpenzimeve si rezultat i pagesave të drejtëpërdrejta nga Thesari

E gjetura Në bazë të Vendimit të Gjykatës gjatë vitit 2018, janë kryer pagesat në vlerë prej 98,400€ nga të cilat 97,429€ janë kryer drejtëpërdrejtë nga Thesari, ndërsa Komuna ka kryer pagesën në vlerë prej 971€.

Nga shuma e cekur, pagesat për paga dhe shujta në vlerë prej 9,308€ të ekzekutuara nga thesari ishin klasifikuara gabimisht nga kategoria për mallra dhe shërbime në shumë prej 6,024€, dhe pagesa për shpenzime (shpenzime gjyqësore, interesi dhe dënime) në shumë prej 3,284€ nga kategoria e investimeve kapitale.

Si rezultat i ekzekutimit të pagesave në bazë të vendimeve gjyqësore, ankuesve u është paguar shuma prej 90,775€, ndërsa për shpenzimet e procedurës ishte paguar shuma prej 7,625€.

Rreziku Klasifikimi jo i rregullt i shpenzimeve, sjell deri tek paraqitja jo e rregullt e shpenzimeve në Pasqyrat Financiare, në këtë rast mbivlerësim të shpenzimeve të kategorisë mallra dhe shërbime dhe nënvlerësim të shpenzimeve në kategorinë paga dhe mëdijë.

Rekomandimi : Kryetari duhet të sigurojë përgjegjësi më të madhe në kryerjen e detyrimeve me kohë ndaj operatorëve, si dhe që gjatë planifikimit të buxhetit duhet ta bëjë vlerësimin e shumave të mundshme të trijdhës së pasasë së gatshme nga kontestet gjyqësore dhe që ato të paguhen në kuadër të buxhetit vjetor, në mënyrë që të shmanget paraqitja e gabuar dhe të mos rrezikohet zbatimi i shpenzimeve tjera të planifikuara.

3. Dhënia me qira e pronës komunale pa iu nënshtuar procedurave të duhura

E gjelura Sipas ligjit Nr. 04/L - 144 për dhënie në shfrytëzim dhe shkëmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Kryetari i Komunës i Propozon Kuvendit të Komunës (MA) që ta lejojë pronën e paluajtshme për ta shfrytëzuar, dhe pas dhënies së pëlqimit nga Kuvendi i Komunës, ajo e themelon Komisionin i cili i vlerëson ofertat përmes ankandit publik. Nga tri kontratat e lidhura gjatë vitit, në një rastet Komuna nuk iu është përmbajtur këtyre kërkesave ligjore, gjatë dhënies së pronës komunale me qira, përkatësisht, nuk ka zbatuar procedurën e ankandit.

Rreziku Dështimi për të zbatuar procedurat në pajtim me kërkesat ligjore, sjell deri te dhënia e kundërligjshme e pronës së paluajtshme në shfrytëzim dhe, si rezultat i kësaj, menaxhimi i pronës nuk është kryer në mënyrë të rregullt.

Rekomandimi B2 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se dhënia e pronës komunale në shfrytëzim të kryhet sipas procedurave të parapara ligjore dhe vendimeve të Kuvendit Komunal.

4. Mangësi në vendimin për shfrytëzimin e pronave

E gjelura Rregulloja e brendshme për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha, në nenin 12, pika 12.1.3, thekson se çmimi për shfrytëzimin e hapësirave publike për lokale është 2€ / m² / në muaj. Drejtoria për Shërbime publike dhe Emergjencia, ka marrë Vendime në tetë (8) raste për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm të hapësirave publike në të cilat nuk specifikohet periudha e as çmimi për muaj. Kjo për shkak të mosfunksionimit të kontroleve dhe mungesa e kompetencës së stafit përgjegjës.

Rreziku Mos specifikimi i periudhës rrezikon që taksa mos të paguhet për periudhën e plotë kohore, si dhe që përlogaritja e saj të mos jetë e saktë, gjë që rrezikon mbledhje në të ulët të të hyrave.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë një kontroll më të lart në Drejtorinë për Shërbime Publike, në mënyrë që Rregulloja e brendshme për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha të zbatohet në tërësi dhe vendimet të jen të qarta dhe të sakta.

5. Koeficiente të gabuara për përlogaritjen e pagave në Arsim

E gjelura Bazuar në Ligjin e Punës Nr.03/L-212, Ligji për pagat e shërbyesve publik, dhe me tri Vendimet e Qeverisë të datave 2011, 2014 dhe 2018 përcaktohet baza për përlogaritjen e pagave për stafin e arsimit.

Kemi gjetur se në Drejtorinë e Arsimit, janë punësuar tri (3) mësuese (në vitin 2018) si zëvendësues të lehonave dhe kanë pranuar paga të përlogaritura sipas koeficientit të gabuar A - 382, i cili deri në vitin 2011 ishte në përdorim kryesisht për mësuesit e Arsimit Fillor, ndërsa nga viti 2011 ai nuk zbatohet më.

Me analizë të detajuar u vërtetua se për shkak të përlogaritjes së gabuar, komuna për dy zyrtare kishte paguar shumë të zvogëluar të pagave për 108€. Shkak i këtij problemi ishte kontrolli jo adekuat i brendshëm dhe reagim jo në kohë për parregullsitë krijuara.

Rreziku Për shkak të kontrollit jo adekuat të brendshëm, komuna në të ardhmen mund të ballafaqohet me parregullsi të ngjashme me rëndësi materiale më të madhe, e cila do të mund të

6. Parregullsi në shkolla për aftësimin profesional

E gjetura Me auditimin e Shkollës për Aftësim Profesional të rriturve, u identifikuan parregullsitë, si në vijim:

Menaxhmenti i Komunës me vetëiniciative kishte marrë Vendim për formimin e Shkollës për Aftësimin profesional të rriturve, pa pëlqim me shkrim, përkatësisht Vendimit nga MASH-T. Kjo ishte në kundërshtim me Ligji nr.04/L-143 për Aftësimin Profesional të Rriturve, si dhe nenin 2 të Udhëzimit Administrativ të MASH-T-it, 08/2015 për Formimin e Institucioneve Arsimore;

Po ashtu, për planin dhe programin e zbatuar nuk është marrë pëlqimi i MASH-T-it, me çka është shkelur Udhëzimin Administrativ nr. 13/2014, për Planin vjetor të punës dhe plani zhvillimor i ofruesve për të arsimet formal të të rriturve. Kjo ka sjellë që në Diarin shkollor të shënohen deri në tri dhjetë orë të mbajtura në ditë, në një klasë;

Komuna nuk e ka respektuar Udhëzimin Administrativ të MASH-T-it nr. 05/2014 për Agjencinë Qeveritare për Aftësimin Profesional të Rriturve, e as Ligjin nr.04/L-138 neni 13 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, për administrim dhe udhëheqje të institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional. Pra kjo shkollë nuk është menaxhuar/ mbikëqyrur nga Agjencioni Qeveritar në lidhje me udhëheqjen, por edhe në kuptimin administrativ dhe pedagogjik; dhe

Përzgjedhja dhe pagesa e personelit të arsimtarëve dhe stafit ndihmës nuk është rregulluar me asnjë Rregullore/ Rregullore të Brendshme Drejtori i shkollës në mënyrë të pavarur e bënë përzgjedhjen e kuadrit arsimor dhe teknik dhe merr vendime për lartësimin e kompensimit për të punësuarit. Të punësuarit nuk kanë kontrata për punë shtesë. Ata punojnë dhe paguhen në bazë të kontratës të cilën e posedojnë për punët primare në shkolla të rregullta. Zyrtaret nuk kanë mundur ta arsyelojnë, anashkalimin e këtyre proceduarve.

Rreziku Për shkak të këtyre parregullsive, komuna mund të ballafaqohet me organet e drejtësisë, për shkak se themelimi dhe funksionimi i kësaj shkolle nuk përputhet me rregullat në fuqi.

Rekomandimi : Kryetari i Komunës duhet që ti përcaktojë përgjegjësitë e atyre të cilët me veprime të veta kanë sjellë komunën në këtë gjendje të pafavorshme, dhe të ndërmeret masat e përshtatshme në pajtim me ligjin. Të forcojë kontrollin e brendshme, në mënyrë që në të ardhmen të gjitha aktivitetet në lidhje me organizimin, funksionimin dhe financimin e shkollës për të rriturit të përshtaten në plotësi me Ligjet dhe Udhëzimet Administrative të MASH-T-it.

7. Marrëveshjet për shërbime të veçanta pa procedurë

E gjetura Sipas Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës, me rastin e aplikimit të marrëveshjeve për shërbime të veçanta zbatohet procedura e thjeshtëzuar e punësimit. Edhe gjatë vitit 2018, komuna ka vazhduar të angazhojë të punësuar në bazë të marrëveshjes për shërbime të veçanta. Në komunë ishin angazhuar gjithsej 53 të punësuar përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta, ndërsa shuma e paguar për këto shërbime gjatë vitit ishte 53,218€, përfshirë pagesat edhe sipas kontratave nga vitit 2017. Kemi vërejtur se nga 53 të punësuar të cilët ishin angazhuar sipas marrëveshjeve për shërbime të veçanta, 42 nga ta ishin të angazhuar pa procedurë të punësimit. Pozitat në të cilat ishin bërë ato punë kanë të bëjnë kryesisht në Njësinë e Tatimit në Pronë, Shërbimin për Regjistrim, Shërbimin Zjarrfikës dhe Pedagogë në Shkollë. Si arsyetim për angazhimin në këtë mënyrë ishte sepse Ministria e Financave nuk e kishte lejuar rritjen e numrit të personelit.

Kreziku I kja nga procedura e punësimit gjatë lidhjes së kontratës për kushte të veçanta mund të sjellë deri te kështu e personave joadekuat për kryerjen e shërbimeve të nevojshme, e cila gjë mund të sjellë deri te mos efektiviteti operativ dhe moskryerja e objektivave të organizatës. Kjo po ashtu nuk ofron trajtim të barabartë për të gjithë konkurrentët potencial.

Rekomandimi : Kryetari duhet të siguroj se marrëveshjet për shërbime të veçanta të lidhen pas zbatimit të procedurave të thjeshtëzuara të punësimit, përmes konkursit publik dhe vetëm në rastet e kërkesave specifike për punë, dhe jo për pozita të rregullta.

8. Vonesa në nënshkrimin e deklaratës në betim

E gjetura Anëtarët e Komisionit për vlerësimin e ofertave duhet të japin deklaratë nën betim e cila duhet të jetë e nënshkruar në momentin e fillimit të punës (vlerësimit), apo më së voni 5 ditë pas hapjes së ofertave, siç përcaktohet me nenin 41.2 të Rregullores për udhëzimet operative për prokurim publik. Në tri raste, anëtarët e Komisionit për vlerësim të tenderit kanë nënshkruar Deklaratën nën Betim me vonesë. Kjo reflekton në kontrole jo funksional të vendosura nga komuna.

Rizik Anashkalimi i proceduarve mund të rezultojë me komisione jo valide apo vonesa në vlerësimin e ofertave.

Rekomandimi : Kryetari të sigurohet se kontrollet e vendosura janë duke funksionuar dhe dëshmitë për funksionin të këtyre kontrolleve të plotësohen sipas afateve të parapara me rregulla.

9. Mangësi në procesimin e pagesave

E gjetura

Rreziku Komuna ka kryer tri (3) pagesa në vlerë të përgjithshme prej 18,084€, duke pranuar dhe paguar fatura para se të behët zotimi mjeteve. Për me tepër tek rasti i "furnizimi me material të shtypur, material reklamues etj" kontrata është lidhur me 20.03.2018, fatura dhe pranimi i malli në depo me datë 21.03.2018 ndërsa zotimi i mjeteve apo kërkesa zotimi për blerje është e mëvonshme apo 13.04.18, urdhër blerje me 18.04.2018 dhe raporti i pranimi 19.04.2018. Kjo për shkak të mangësive në planifikimin e shpenzimeve dhe kontrolleve jo funksionale në kontraktimin pa zotim të mjeteve.

Rreziku Mungesa mjeteve të nevojshme ka reflektuar në vonesa për pagesën me kohë të fatrave e cila ka mundësi të rritë obligimet /detyrimeve e ndërmarrja nga komuna. Vonesat mund edhe të vendosnin komunën para institucione të drejtësisë dhe përpalljen me shpenzime shtesë.

Rekomandimi A6 Kryeri duhet të sigurohet se furnizimi i paraprin urdhëresa për blerje e cila është e mbuluar me zotim të mjaftueshme të mjeteve, apo mjetet duhet të sigurohen para se të hyhet në obligime kontraktuale.

10. Mosrespektimi i Rregullores së brendshme dhe Ligjit në fuqi

E gjetura Kriteret bazë në të cilat auditimi i këtij problemi do të bazohet kanë të bëjnë me Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, si dhe në Rregulloren e brendshme për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Vitësë.

Komuna herën e parë me 27.02.2018, në vlerë prej 10,000€ dhe herën e dytë me 18.05.2018, në vlerë prej 5,000€ i kishte dhënë subvencion "KF Vllaznia" nga Pozharani, dhe në të dyja rastet nuk e ka respektuar Rregulloren e brendshme për ndarjen e subvencioneve. Kryetari nuk e ka emëruar Komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave, me çka është shkelur neni 7 i Rregullores së brendshme; shfrytëzuesi i subvencionit nuk e ka ofruar dokumentacionin e nevojshëm në aplikacionin e tij, me çka nuk është respektuar neni 22, pika 3 e Rregullores (në dokumentacionin e ofruar ekziston vetëm vendimi për ndarje), dhe në fund nuk ka raportim nga ana e shfrytëzuesit të subvencionit, me çka është shkelur pika 2 e Vendimit në bazë të cilit është ndarë subvencionit.

Shkaku i këtij problemi qëndron në faktin se menaxhmenti nuk i ka përfillur rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm nga viti i kaluar, prandaj në vitin 2018 e ka përsëritur gabimin e njëjtë. Pra kjo situatë vazhdon të përsëritet për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të vendosura me rregulla.

Rreziku Komuna e Vitësë, për shkak të mosrespektimit të dispozitave të Rregullores së brendshme e krijon mundësinë për keqpërdorim të parashë publike, si dhe mundësinë që subvencionet e ndara të mos e arrijnë qëllimin e tyre.

Rekomandimi Kryetari i komunës duhet të sigurojë të gjitha masat në mënyrë që ta forcojë kontrollin e brendshëm të tërë procesit të ndarjes së subvencioneve, duke filluar nga Thirrja Publike, përmes respektimit të Rregullores gjatë aplikimit, emërimit dhe punës së Komisionit, e deri te raportimi, e gjithë kjo me qëllim që subvencionet e ndara ta arrijnë qëllimin e tyre.

11. Mosrespektimi i marrëveshjes dhe pagesa të parregullta

E gjetura Me rastin e ndarjes së subvencioneve komuna duhet të bazohet në Ligjin nr. 03/L-048 për menaxhimin dhe përgjegjësitë për punë në financa publike, si dhe Rregullorja e brendshme për ndarjen e subvencioneve të Komunës së Vitisë.

Komuna e Vitisë ka nënshkruar një marrëveshje me organizatën zvicerane Helvetas për shpërndarjen e pajisjeve për fermerët. Vlera e kontratës është në shumën totale prej 34,184€ (50 copë makina për shpërndarje të plehut, 114 bidon për qumësht, 50 rezervuar ujë 1,000 litra, 30 mol kultivator, etj.). Shuma e përgjithshme e buxheti komunal për këtë projekt është 16,532€, pjesëmarrja e fermerëve është 7,266 € dhe Helvetas ka një pjesë prej 10,386€.

Komuna nuk ka zbatuar procedurën e tenderit në pajtim me specifikimet në marrëveshje, në kuptim të sasisë dhe llojit të aktivitetit.

Komuna e ka ndarë tenderin në dy procedura duke nënshkruar dy kontrata me dy OE. Në kuadër të kontratës së parë, janë përcaktuar tre aktivitete (shpërndarëset e plehut, bidona për qumësht dhe rezervuarë ujë) në shumën totale prej 16,596€, që përfaqëson buxhetin e përgjithshëm komunal për tërë projektin.

Pastaj ka nënshkruar një kontratë tjetër në vlerë prej 4,158€ për ekzekutimin e një aktiviteti (blerja e 22 moto kultivator). Komuna ka paguar një shumë prej 2,079€ për kontratën.

Kjo marrëveshje nuk u respektua as me sasi e as me vlerë, por me një aneks ishte ndryshuar në përfundim të procesit, përkatësisht pak para kryerjes së pagesës.

Komuna sipas kontratës së parë i kishte paguar furnizuesit shumën prej 6,842€ nga të hyrat velfake, ndërsa shumën prej 4,149€ nga participimi i qytetarëve, derisa organizata Helvetas kishte paguar 4,149€. Edhe pse participimi i shfrytëzuesve për këtë projekt ishin saktesisht 4,149€, komuna nuk i ka përdorur në tërësi këto mjete për pagesën e furnitorit për furnizimin e kryer, por ka përdorur mjete të ndara të destinuara të projektit tjetër (nga viti 2017, në vlerë prej 1,456€) pra janë shfrytëzuar vetëm 2,693€ parat / participimi i destinuar për këtë projekt, tjerat janë bartur për vitin e ardhshëm. Për shkak të menaxhimit të dobët me financa, përkatësisht, mosrespektimit të marrëveshjeve, ndodh që mjete të destinuara për të cilën kanë participuar qytetarët mos të jenë shpenzuar në pajtim me qëllimin e tyre.

Rreziku Mosrespektimi i marrëveshjes dhe menaxhimi i dobët me financa, përkatësisht shpenzimi i mjeteve të destinuara për qëllime tjera, mund të krijojë për komunën borxhe të panevojshme, madje edhe procedura gjyqësore.

Rekomandimi Kryetarin e Komunës duhet të vërtetojë arsyet për mosrespektimin e marrëveshjeve të artitura, si dhe mos shpenzimin e mjeteve të destinuara për qëllime për të cilat ishin mbledhur nga participimi i qytetarëve, dhe ta forcojë kontrollin e brendshëm në këtë fushë, në mënyrë që kjo të mos ndodhë në të ardhmen.

12. Mungesa e lejeve të ndërtimit, mbikëqyrjes inspektive dhe lejes së përdorimit

E gjetura Sipas Ligjit të ndërtimit, me rasin e kontratave ndërtimore kërkohet pajisja me dokumentacionin përkatës siç është leja ndërtimore, mbikëqyrja inspektive si dhe leja e përdorimit. Komuna në tri (3) raste nuk kishte aplikuar lejet ndërtimore apo mbikëqyrjen inspektive. Gjithashtu, kemi identifikuar se komuna nuk leshon leje përdorimit ende për as një objekt të përfunduar.

Kreziku Incimi i projekteve në mungesë të kompletimit të dokumentacionit sipas kërkesave të ligjit për ndërtim, mund të ndikojë në cilësinë dhe ngecjen në realizimin e këtyre projekteve.

Rekomandimi Kryetari duhet të siguroj se projektet janë pajisur me dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kërkesat e Ligjit të ndërtimit, me ç' rast fillimisht sigurohet leja ndërtimore, mbikëqyrja inspektive gjatë ekzekutimit dhe në fund të projektit edhe leja e përdorimit.

13. Dobësi në regjistrimin dhe menaxhimin me pasuritë

E gjetura Pavarësisht nga rekomandimet e dhëna në vitet e kaluara, çështjet që ndërliken me pronën bazuar në Rregullën Financiare nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare, ende janë sfidë për komunën:

Katër shkollat të cilat i financon MASHT-i, të cilat komuna i shfrytëzon nga viti 2012, ishin të regjistruara në regjistrin e pasurisë në mungesë të dokumentacionit përcjellës, vetëm përmes e-mailave të dërguar nga ana e zyrtarit të MASHT-it. Edhe përkundër kërkesës së zyrtarit për pasuri për ofrimin e këtij dokumentacioni, MASHT-i ende nuk është përgjigjur pozitivisht dhe komunës nuk i janë dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm për barthen e pronësisë; dhe

Inventari të cilin MAPL e kishte blerë në vitin 2012, në vlerë prej 30,000€, nuk ishte i përfshirë në regjistrat e pasurisë edhe pse ishte vendosur në depot e objektit të ri të komunës. Kjo kishte ndodhur për shkak se zyrtari i parimit nuk ishte i njohur për pasurin e pranuar nga komisioni, dhe pasuria ende nuk është regjistruar në regjistrin E-pasurisë, edhe pas rekomandimit tonë nga viti i kaluar.

Kreziku Mungesa e dokumentacionit për pasurinë e regjistruar, të cilën e shfrytëzon komuna, rezultoi me pasiguri për pronësinë mbi këto pasuri. Marrë parasysh mos regjistrimi dhe mbajtja në depo e pasurisë për kohë të gjatë si e pa shfrytëzuar, rrezikon që të shkatërrohen apo keqpërdoren këto pasuri.

Rekomandimi Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontroleve të menaxhimit të pasurisë, në këtë rast, në mënyrë që të sigurohet se po ndërmerren hapat konkret për ofrimin e dokumentacionit burimor nga MASHT-i dhe regjistrimit të pasurisë të financuara nga ana e MAPL-ja, në regjistrat e pasurisë së komunës.

14. Menaxhim jo i mirë i llogarive e të arkëtueshme

E gjetura . Të Arkëtueshmet nga tatimi në pronë menaxhohen dobët. Në regjistrin e taksapaguesve ekzistojnë borxhlinj të tatimit (292 borxhlinj), borxhi i të cilëve është në vlerë prej 1,000€ deri në 37,103€, ku detyrimi i përgjithshëm kap vlerën 665,923€, përkatësisht mbi 40% të arkëtueshmëve të përgjithshme.

Komuna nuk ka ndërmarrë masat efektive për pagesën e të arkëtueshmëve, duke bërë që këto të jenë në rritje në raport me vitin e kaluar. Kjo është pasojë e mos zbatimit të mekanizmave të komunës për rritjen e arkëtimit të të hyrave.

Rreziku Rritja e llogarive të arkëtueshme dhe pamundësia për ti mbledhur me kohë rezulton me menaxhim jo efektiv të tyre për shkak të pamundësisë së komunës për ndërmarrjen e masave adekuata për arkëtimin e tyre. Mungesa e masave konkrete për mbledhjen e LI/A, ndikon në moskryerjen e shpenzimeve të planifikuara nga të hyrat.

Rekomandimi Kryetari duhet ta fillojë procesin e rishqyrtimit, ku do të analizoheshin të gjitha llogaritë, në kuptimin e vjetërsisë, shumave të rëndësishme, mundësi reale për pagesë dhe zbatimit të masave ligjore për mbledhjen e tyre.

15. Raportimi i gabuar dhe evidentimi joadekuat i detyrimeve

E gjetura Sipas Rregullën Financiare nr.02/2013për raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore neni 5: Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që në Ministrinë e Financave - Thesar të raportojnë obligimet e tyre të papaguara. Përmes procedurave të auditimit kemi gjetur që shumta e shpalosur në PFV për 2018 nuk jep pasqyrë të drejtë të obligimeve, për shkaket në vazhdim:

☐ Detyrimi ndaj një furnitori, në vlerë prej 4,035€ u paraqit në raportin financiar si detyrim i papaguar dhe si detyrim kontingjent;

☐ Obligimi kundrejt furnitorit në vlerë prej 9,087€, është paguar në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të faturës, ndërsa nuk do të duhej të paraqitej në raportin për MF në lidhje me pagesat e pakryera; dhe

☐ Obligimi ndaj një furnitori, në vlerë të përgjithshme prej 7,384€, ishte paguar në dhjetor të vitit 2016, ndërsa gjendet në PFV për 2018. Menaxhmenti i komunës nuk mbante evidencën adekuatë për faturat e pranuar dhe të paguara.

Rizik Raportimi për obligimet të cilat ende janë në afatin e lejuar ligjor, rritë rrezikun që komuna të jep informata të gabuara menaxhementit, ndërsa, paraqitja e obligimeve në shumë më të madhe se sa që është real, rritë rrezikun e pagesës pa obligim. Paraqitja e obligimeve edhe në kuadër të obligimeve potenciale, sjellë deri te paraqitja e të dhënave të pasakta në PFV. Po ashtu është krijuar rreziku nga humbja e parasë publike, përkatësisht, që faturat e caktuara të paguhen disa herë.

Rekomandimi Kryetari, duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshëm të kësaj fushe, dhe të bëjë ndajë më të mirë të detyrave ndërmjet të punësuarve, në mënyrë që të vendoset një sistem më efikas i evidentimit të faturave të pranuar dhe të paguara, dhe të cilat do të rezultojnë me informata më të sakta për gjendjen e llogarive të papaguara dhe pagimin më të rregullt të borxheve.

16. Mos zbatimi i rekomandimeve e nga auditori i brendshëm

E gjetura Numri i auditimeve të planifikuara nga ana e NjAB për 2018 ishte 7, ndërsa deri në fund të vitit ishin kryer 6 auditime. Nga gjithsej 25 rekomandime, vetëm 8 janë zbatuar në tërësi, 10 janë në proces të zbatimit, ndërsa 7 nuk janë zbatuar. Rekomandimet e dhëna kryesisht kanë mbuluar vitin e kaluar, deri në tremujorin e tretë të vitit aktual. Këto rezultate tregojnë mosgatishmërinë e menaxhmentit që të shfrytëzojnë benefitet nga auditori i brendshëm dhe sigurinë gjatë punës së kontrolleve të brendshme.

Kreziku Mos zbatimi i rekomandimeve nga menaxhmenti dhe angazhim jo i mjaftueshëm i AB në këtë kuptim, e zvogëlon efikasitetin e kontrolleve të brendshme dhe përsëritjen e dobësive të identifikuara.

Rekomandimi Kryetari duhet të sigurojë që fushëveprimi i NjAB të përfshinë sa më shumë që është e mundur, periudhën aktuale me ndihmën e aktiviteteve operative trijdhëse. Njëkohësisht, duhet të ketë një fokus më të madh i menaxhmentit në adresimin e rekomandimeve dhe punës më aktive të AB në plotësimin e këtij objekti.

17. Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e krezikut

E gjetura Si rezultat i funksionimit jo të rregullt të kontrollit të menaxhimit, një sasi e konsiderueshme e shpenzimeve nga ana e zbatimit të vendimeve të organeve gjyqësore, të cilat kanë shkakuar shpenzime shesë në buxhetin e komunës dhe kanë krezikuar krijimin e projekteve tjera të planifikuara, për shkak të lërheqes së drejtpërdrejtë nga Thesari nëpër kategori të ndryshme.

Si pasojë e mosfunksionimit të kontrolleve të menaxhmentit, menaxhimi jo adekuat në pranimet dhe përcjelljen e llogarive, ka bërë që obligimin të mos jetë i shpërfaqur në vlerë të saktë në PFV. Dobësitë menaxheriale janë të vërejtura në fushën e subvencioneve, ku kontrollet nuk kanë vepruar mjaftueshëm në mënyrë që të shpërndaheshin dhe raportoheshin shpenzimet për këtë kategori. Të ardhshmet janë rritur dhe nuk janë ndërmarrë masa të veçanta për arktimin e tyre. Po ashtu, objektet me qira ende shfrytëzohen në kundërshtim me ligjin. Nga ana tjetër, pasuria nuk ka pasqyruar situatën e saktë.

Menaxhmenti nuk ka raporte të rregullta për aktivitetet operative dhe analizën delaje të performancës së buxhetit. Komuna e ka regjistruar e tregimeve, megjithatë, mungon pronësia mbi këto tregime dhe mekanizmat për përcjellje dhe raportim të Zyrtarit Kryesor Administrativ.

Kreziku Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar i dobët, reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezultoi me dobësi në procesin buxhetor si dhe në reduktimin e mundësisë që menaxhmenti të reagojë ndaj sfidave financiare me kohë. Kjo po ashtu

zvogëlton efektin e kontroleve buxhetore dhe rriti trezikun për shpenzime jo të rregullta. E gjithë kjo mund të rezultojë edhe në ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

Rekomandimi : Kryetari, duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, plani i prokurimit, duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, të përcaktohet pronësia mbi trezigtë e identifikuar të individëve të caktuar, apo Bordit për menaxhimin e trezigeve, të cilit do të raportojnë tek Zytari Kryesor Administrativ, në lidhje me trezigtë, përfshirë edhe auditimet e rregullta (tremujore) në mënyrë që të vërtetohet nëse janë ndërmarrë masat ashtu siç ishin planifikuar.

Janë marrë për bazë të gjitha rekomandimet e gjetura nga zyra kombëtare e auditimit , ne i kemi adresuar rekomandimet dhe jemi duke bërë planin e veprimit për adresimin e këtyre të gjeturave , do të angazhohemi në adresimin e të gjeturave për të krijuar një rregullsi për të pasur një prezntim të sakt në të dhënat e RVF 2019 sepse të gjithë akterët (punonjësit) me të gjaturat e auditorit të jashtëm janë njoftuar do të jenë të përkushtuar që tëshimet e gjetura të mos përsëriten në periudhën e ardhshme raportuese.

Date 17.07.2019

Viti

